

PËR MËSUESIN/EN

duk^agjini
shtëpia botuese publishing house

**Merita Dervishaj, Arita Ademi,
Fahrije Maxharraj**

SHKATHTËSI PËR JETË

Për klasën e katërt të arsimit fillor

4



PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes	5
Hyrje	7
Planifikimi vjetor	16
Plani dymujor: shtator—tetor	17
Plani dymujor: nëntor—dhjetor	20
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	23
Plani tremujor: prill—maj—qershor	27
Mësimi 1: Strukturimi i formave dhe i figurave të ndryshme - Figurat gjeometrike	30
Mësimi 2: Trupat gjeometrikë	32
Mësimi 3: Shpalosja e sipërfaqes së trupave - Punimi i kubit nga letra	34
Mësimi 4: Modelimi me qepje, thurje dhe qëndisje	36
Mësimi 5: Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme	38
Mësimi 6: Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme - Veprimtari praktike	40
Mësimi 7: Thurja me një kërrabëz.....	42
Mësimi 8: Thurja me dy kërrabëza.....	44
Mësimi 9: Qëndisja.....	46
Mësimi 10: Ekspozimi i punimeve	48
Mësimi 11: Përdorimi i aparateve dhe i veglave elektrike	50
Mësimi 12: Përgatitja e supës kremoze dhe kujdesi nga rreziqet e mundshme	52
Mësimi 13: Përdorimi i mikserit, i blueses së frutave: përgatitja e ëmbëlsirës pa pjekje	54
Mësimi 14: Përdorimi i drejtë i pajisjeve shtëpiake	56
Mësimi 15: Përdorimi i drejtë i pajisjeve shtëpiake - Përforcim	58
Mësimi 16: Çfarë dimë për profesionet?	60
Mësimi 17: Mësojmë më shumë për punët e të rriturve	62
Mësimi 18: Mësojmë më shumë për punën e të rriturve - Përsëritje.....	64
Mësimi 19: Një vizitë në biznese	66
Mësimi 20: Mësojmë programimin në kompjuter	68
Mësimi 21: Mësojmë të vizatojmë me kompjuter	70
Mësimi 22: Si të vizatojmë me programin Paint?.....	72
Mësimi 23: Planifikojmë obligimet e javës.....	74
Mësimi 24: Ndihmojmë në kuzhinë.....	76
Mësimi 25: Domethënia e shenjave të rrezikut lidhur me mbeturinat e caktuara	78
Mësimi 26: Shkalla e rrezikut nga mbeturinat e caktuara.....	80
Mësimi 27: Ndikimi i cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut	82
Mësimi 28: Si ta mbrojmë mjedisin dhe shëndetin tonë?	84
Mësimi 29: Disa porosi për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit	86
Mësimi 30: Shqetësimi i njeriut për sasinë e mbeturinave.....	88
Mësimi 31: Përpunimi i gjërave të ndryshme me materiale ricikluese - Punimi i shportës me qese plastike	90
Mësimi 32: Çantë e thurur me grep	92
Mësimi 33: Siguria në internet.....	94
Mësimi 34: Përdorimi i kompjuterit për sigurinë në internet	96
Mësimi 35: Rëndësia e ruajtjes së të dhënave personale.....	98
Mësimi 36: Kërkimi i informacioneve në internet.....	100
Mësimi 37: Radioja, televizioni dhe mediet sociale	102

Të dashur mësues dhe mësuese,

Ky libër është hartuar me qëllimin për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimit. Sot kemi mundësinë që arsimimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" aplikon metodologji bashkëkohore të mësimit ndërrprurë në librat e mësuesve, që ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: *Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathhtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Republikës së Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?*

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimit dhe të të nxënësve, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.


Cilësia e re e të nxënësve dhe e mësimit përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por nga ju kërkohet edhe të përdorni metoda dinamike të mësimit, të quajtura edhe metoda mësimore ndërrprurë, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen maksimalisht në mësim.

Modeli i këtyre librave dhe mësimit janë hartuar me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë


- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënës, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.
- Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënës.
- Parashikimi është faza e parë e orës mësimore që siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Rezultatet e të nxënës të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjerë.
- Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zbrëthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.
- Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentoohen.

Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin gjatë përgatitjes.
- Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënës.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



- Përpunimi i përmbajtjes është faza e dytë e orës mësimore, ku bëhet përzgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik të tij.
- Përforsimi është faza e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe shprehive, si dhe zbatimi i tyre.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësim

Rezultatet e të nxënës të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme të cilat janë pika referuese për përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënës për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me kurrikulën bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënës të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënës dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Filluar nga klasa e tretë e më lart, zotërojnë operacionet mendore, të menduarit e tyre është konkret me elemente të të menduarit abstrakt, prandaj mësimi me këta nxënës kalon në tri faza të të menduarit të nxënësve sipas proceseve njohëse. Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve: Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës e që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - Fazat e zhvillimit të mësimi: Mësimi zhvillohet përmes fazave, duke nxitur të menduarit logjik e kritik të nxënësve, duke pasur parasysh fazat e zhvillimit sipas Piazhesë.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimi?

Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi/ja vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të ecur më tej përpara.

Parashikimi: Përgatitja për të nxënës

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.



Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të nxënësve, kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimi, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes.

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive, gjithashtu ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve.

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësve e ri dhe, në mënyrë të gjallë, ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.



HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

SHKATHTËSI PËR JETË 4

Përderisa përgatitja për jetë dhe për punë theksohet në tërë kurrikulën si një çështje e rëndësishme, fusha e kurrikulës “Jeta dhe puna” synon të kontribuojë veçanërisht si një fushë “mbartëse” në zhvillimin e kompetencave për jetë dhe për punë. Në shkallët 1 dhe 2 të kurrikulës, ajo përqendrohet në shkathtësitë për jetë, krahas shkathtësive që kanë të bëjnë me artizanatet dhe amvisërinë. Përmes kësaj fushe të kurrikulës, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si: anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijësimin dhe vetëbesimin duke qenë po ashtu të vetëdijshëm për ekzistimin e të tjerëve dhe nevojës për t'u mbështetur në marrëdhënie ndërpersonale në jetë dhe në punë për sa i përket tolerancës dhe respektit të ndërsjellë. Ata do të zhvillojnë shpirtin për iniciativë dhe përgjegjshmëri; të hartojnë dhe të respektojnë planet e punës dhe afatet kohore, si dhe të njihen me cilësinë e proceseve dhe të rezultateve të tyre.


Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën kurrikulare “Jeta dhe puna” mund të përdoren metodat e ndryshme të punës, me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo fushë, por edhe për shkak të specifikave që bart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësit

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimit e shkathtësive. Ai i trajton temat mësimore në përputhje me “Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës” (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësit të fushës, rezultatet specifike të të nxënësit të njësive mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimin e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arrijtjet, por edhe mossuksesin, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënësit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënësit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndësh magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënësit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënësit dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



Burimi: Metodologji e mësimdhënies, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni:
Musai. B. (2014) *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.


Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve për ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijuar është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshtarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënja mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni:
Woolfolk. A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshtar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2.	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3.	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4.	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5.	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7.	Shpreh, në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi/ja në gjuhë të huaj të dhëna si detyrë.
8.	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
2.	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3.	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4.	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencë e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5.	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6.	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, historiko-shoqërore) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7.	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minuta.
8.	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm	
1.	Parashtron pyetje që nxësin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes.
2.	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3.	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
4.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5.	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6.	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
7.	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8.	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9.	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinën për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
1.	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.
2.	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.
3.	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
4.	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
5.	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6.	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
7.	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë.
8.	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

1.	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike-lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3.	Përgatit një listë (me njërin nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqime të cilat i konsumon familja duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4.	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5.	Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6.	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8.	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).
9.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1.	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.
2.	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
3.	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.
4.	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5.	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësues, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6.	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërit rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7.	Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8.	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet, mënyrat e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9.	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS JETA DHE PUNA **Shkalla 2**

1. NJOHURITË, TË KUPTUARIT, SHKATHTËSITË që zhvillohen	
1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet Nxënësi/ja:	
1.	Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup;
2.	Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.
2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë	
Nxënësi/ja:	
1.	Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.
3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme	
Nxënësi/ja:	
1.	Përdor vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë.
2.	Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në udhëzimet e mësuesit/es.
4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme	
Nxënësi/ja:	
1.	Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.
2.	Përdor i sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.
5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit	
Nxënësi/ja:	
1.	Drejtëpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative-buxhetore.
6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë	
Nxënësi/ja:	
1.	Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.

7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme

Nxënësi/ja:

1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësisë, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.

8. Komunikimi në/për jetë dhe punë

Nxënësi/ja:

1. Është i vetëdijshëm për ekzistimin e diversitetit individual në klasë, në shkollë dhe në jetë për të përmirësuar të kuptuarit, dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore.

9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm - mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit

Nxënësi/ja:

1. Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.
2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

II. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen

- Toleranca
- Respektimi i diversitetit
- Përkushtimi
- Qëndrimi pozitiv
- Bashkëpunimi
- Respektimi i kodit të mirësjelljes
- Respektimi rregullor
- Gatishmëria
- Siguria
- Pavarësia në mendime dhe në veprime
- Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme
- Besimi në përdorimin e TIK-ut
- Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit
- Gatishmëria për bashkëpunim

III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË që zhvillohen

- Njeh veten dhe të tjerët
- Tregon për veten, për familjen dhe për mjedisin
- Identifikon rreziqet e ndryshme
- Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative
- Shkëmben përvojat
- Demonstron sjellje, veprime, shprehi
- Praktikon ushtrime
- Ndërton bashkëpunim
- Shfaq vendosmëri

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Jeta dhe puna - Klasa IV

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	GJYSMËVJETORI I		GJYSMËVJETORI II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
SHKATHËTËSI PËR JETË	Materialet dhe përpunimi tyre (9 orë)	Materialet dhe përpunimi tyre (1 orë) Njohja nga rreziqet (5 orë) Karriera ime (2 orë)	Karriera ime (3 orë) Planifikimi (4 orë) Mjedisi dhe shëndeti (3 orë)	Mjedisi dhe shëndeti (5 orë) Mediet (5 orë)	<p>I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 8.</p> <p>II Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 8.</p> <p>III Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.</p> <p>IV Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv 2, 3, 4, 5, 7.</p> <p>V Kompetenca personale - Individ i shëndoshë 1, 7, 8, 9.</p> <p>VI Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 2, 8.</p>
	Gjithsej 9 orë	Gjithsej 8 orë	Gjithsej 10 orë	Gjithsej 10 orë	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Klasa: IV

Temat mësimore: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme;
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.7	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.3	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
------	--

Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.	Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet. 1.1 Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup. 1.2 Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdoreje, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.
2	Ngritja e cilësive personale për jetë dhe për punë 2.1 Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Metodologjia e mësimdhënies	Ndiërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Materialet dhe përpunimi i tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strukturon forma dhe figura të ndryshme nga llojet e letrës në mënyrë individuale dhe në grup. - Dallon llojet e qepjes dhe praktikon në jetën e përditshme. - Modelon me qepje, thurje dhe qëndisje. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Strukturimi i formave dhe i figurave të ndryshme - Figurat gjeometrike 2. Trupat gjeometrikë 3. Shpalosja e sipërfaqes së trupave -Punimi i kubit nga letra 4. Modelimi me qepje, thurje dhe qëndisje 5. Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme 6. Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme -Veprimtari praktikë 7. Thurja me një kërrabëz 8. Thurja me dy kërrabëza 9. Qëndisja 	<p>9</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi dhe të nxënërit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Mësimdhënie përmes vëzhgimit, demonstrimit dhe eksperimentit; - Të mësuarit dhe të nxënërit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; - Ushtrimet me luajtje rolesh; - Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathësive, puna interaktive; - Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale. - Edukimi për qytetari demokratike; - Edukimi për paqë; - Globalizimi dhe ndërvlerësia; - Edukimi për medie; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> - Buletini i pjesëmarrjes; - Lista e kontrollit; - Dosja e nxënësit; - Vëzhgimi i drejtpërdrejtë; - Vlerësimi përshkrues; - Projekete. 	<ul style="list-style-type: none"> - Njeriu dhe natyra; - Gjuhë shqipe; - Edukatë figurative; - Shoqëria dhe mjedisi; - Njohja e medias (përdorimi i medias për ta kuptuar botën përreth); - Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë); - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike; - Gjuha dhe shkathësitë e komunikimit; - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë; - Puna vullnetare. 	<p>Tekstet shkollore;</p> <p>Librat e aktiviteve dhe të ushtrimeve;</p> <p>Librat e punës;</p> <p>Broshura;</p> <p>Atlase;</p> <p>Enciklopedi;</p> <p>Softuera arsimorë;</p> <p>Projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune</p> <p>Gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë;</p> <p>https://emesi.mi.rks-gov.net/shq/</p>	

PLANI DYMUIOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Klasa: IV

Temat mësimore: Materialet dhe përpunimi tyre
Njohja nga rreziqet
Karriera ime

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.2	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitave në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimi) të tyre.

Kompetenca e të nxënësve – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.7	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.3	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.;
IV.5	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedis të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë;
IV.7	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendosin për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.8	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.	Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet 1.1 Përkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup. 1.2 Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdoreje, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.
2	Ngritja e cilësive personale për jetë dhe për punë 2.1 Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.
3	Përdorimi i teknologjisë për jetë dhe për punën e përditshme 3.1. Përdor vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë. 3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në udhëzimet e mësuesit/es.
4	Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare; 4.2. Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathëtisë praktike.
6	Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë 6.1. Përkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.
7	Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme 7.1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësisë, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Nërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Materialet dhe përpunimi tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekspozon punimet e tij apo saj në klasë apo shkollë. - Praktikon hekurin për hekurosje në mënyrë të drejtë. - Përdor veglat shtëpiake (përzierës, shtrydhëse frutash, shporet elektrik), duke përgatitur prodhime të ndryshme ushqimore. - Përdor pajisjet shtëpiake në mënyrë të drejtë dhe mbrohet nga rreziqet gjatë përdorimit të tyre. - Paraqet video/foto me mënyrën e punës së profesioneve të ndryshme. - Identifikon disa shkathtësi dhe aftësi për profesionet e ndryshme. - Identifikon llojet e aktiviteteve në shkollë, shtëpi, komunitet dhe tregon lidhjen e tyre me profesionet e ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> 10. Ekspozimi i punimeve 11. Përdorimi i aparateve dhe i veglave elektrike 12. Përgatitja e supës kremoze dhe kujdesi nga rreziqet e mundshme 13. Përdorimi i mikserit, i blueses së frutave: Përgatitja e ëmbëlsirës pa pjekje 14. Përdorimi i drejtë i pajisjeve shtëpiake 15. Përdorimi i drejtë i pajisjeve shtëpiake - Përformim 16. Çfarë dimë për profesionet? 17. Mësojmë më shumë për punët e të rriturve 	8	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi dhe të nxënë në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Mësimdhënie përmes vërtimit, demonstrimit dhe eksperimentit; - Të mësuarit dhe të nxënë përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; - Ushtrimet me luajtje rolesh; - Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe i shkathtësive, puna interaktive; - Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale. - Edukimi për qytetari demokratike; - Edukimi për paqe; - Globalizimi dhe ndërvarësia; - Edukimi për medie; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> - Buletini i pjesëmarrjes; - Lista e kontrollit; - Dosja e nxënësit; - Vëzhgimi i drejtpërdrejtë; - Vlerësimi përshkrues; - Projekte. 	<ul style="list-style-type: none"> - Njeriu dhe natyra; - Gjuhë shqipe; - Edukatë figurative; - Shoqëria dhe mjedisi; - Njohja e medias (përdorimi i medies për ta kuptuar botën përreth); - Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë); - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike; - Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit; - Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë; - Puna vullnetare. 	<ul style="list-style-type: none"> - Tekstet shkollore; - Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve; - Librat e punës; Broshura; Atlase; - Enciklopedi; - Softuera arsimore; - Projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune; Gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë; https://emesi-mi.rks-gov.net/shq/ 	

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Klasa: IV

Temat mësimore: Karriera ime
Planifikimi
Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.2	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera/

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme;
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitave në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Kompetenca e të nxënimit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.2	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre;
IV.3	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.;
IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes;
IV.5	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë;
IV.7	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fzike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes;
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.8	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

Rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.	<p>Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</p> <p>1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavaruara për të finalizuar produkte të ndryshme punëdoreje duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.</p>
4.	<p>Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</p> <p>4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.</p> <p>4.2. Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathësive praktike.</p>
5.	<p>Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit</p> <p>5.1. Drejtpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative–buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit.</p>
6.	<p>Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë</p> <p>6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.</p>
7.	<p>Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</p> <p>7.1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësisë, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.</p>
9.	<p>Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit</p> <p>9.1. Përpunon materiale recikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.</p> <p>9.2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.</p>

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet	
Karriera	<ul style="list-style-type: none"> - Sheh punën (në institucione, punëtori, fabrika etj.) e disa profesionëve të ndryshme. - Krijon modele ose vizatime të thjeshta me anë të programit kompjuterik. 	<p>18. Mësojmë më shumë për punët e të rriturve - Përsëritje</p> <p>19. Një vizitë në biznese</p> <p>20. Mësojmë programim në kompjuter</p> <p>21. Mësojmë të vizatojmë me kompjuter</p> <p>22. Si të vizatojmë në programin Paint?</p> <p>23. Planifikojmë obligimet e javës</p> <p>24. Ndihmojmë në kuzhinë</p> <p>25. Domethënia e shenjave të rrezikut në lidhje me mbeturinat e caktuara</p> <p>26. Shkalla e rrezikut nga mbeturinat e caktuara</p> <p>27. Ndikimi i cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut</p>	10	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi dhe të nxënëti në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Mësimdhënie përmes vrotimit, demonstrimit dhe eksperimentit; - Të mësuarit dhe të nxënëti përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; - Ushtrimet me luajtje rolesh; - Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathërsive, puna interaktive; - Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale. - Edukimi për qytetari demokratike; - Edukimi për paqe; - Globalizimi dhe ndërvarësia; - Edukimi për medie; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm 	<ul style="list-style-type: none"> - Buletini i pjesëmarrjes; - Lista e kontrollit; - Dosja e nxënësit; - Vëzhgimi i drejtpërdrejtë; - Vlerësimi përshtkrues; - Projekte. 	<ul style="list-style-type: none"> - Njeriu dhe natyra; - Gjuhë shqipe; - Edukatë figurative; - Shoqëria dhe mjedisi; - Njohja e medias (përdorimi i medias për ta kuptuar botën përreth); - Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë); - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike; - Gjuha dhe shkathësitë e komunikimit; - Zhvillimi personal dhe shkathësitë të vullnetare. 	<ul style="list-style-type: none"> - Tekstet shkollore; - Librat e aktiviteve dhe të ushtrimeve; - Librat e punës; - Broshura; - Atlase; - Enciklopedi; - Softuera arsimorë; - Projekte; - studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit materiale përkatëse pune - Gazeta, revista, literatura të specializuar apo doracakë; - https://emi.rks-gov.net/shq/
Planifikimi	<ul style="list-style-type: none"> - Planifikon aktivitetet e ekonomisë familjare. 						
Mjedisi dhe shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatit një plan pune njëjavor dhe rendit dhe argumenton veprimet prioritare. - Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit për aktivitetet argëtuese, humanitare dhe ruajtjen e mjedisit - Shpjegon domethënien e shenjave të rrezikut për mbeturina të caktuara. - Argumenton shkallën e rrezikut për secilën mbeturinë. 						

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna
Temat mësimore: Mjedisi dhe shëndeti
 Mediet

Klasa: IV

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv</i>	
I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.2	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme;
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërtimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.2	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre;
IV.3	Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.;
IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes;
IV.5	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedis të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë;
IV.7	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fzike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes;
V.7	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor;
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.8	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

2.	Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë 2.1. Demonstron gatishmëri dhe vetëiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.
4.	Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare. 4.2. Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.
6.	Promovimi i kushteve të sigurt për jetë dhe për punë 6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.
9.	Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit 9.1. Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit. 9.2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
Mjedisi dhe shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon ndikimin e cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut. - Krijon porosi për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. 	<p>28. Si ta mbrojmë mjedisin dhe shëndetin tonë?</p> <p>29. Disa porosi për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit</p>	10	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi dhe të nxënësit bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Mësimdhënie përmes vëzhgimit, demonstrimit dhe eksperimentit; - Të mësuarit dhe të nxënësit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; - Ushtrimet me luajtje rolesh; - Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathtësive, puna interaktive; - Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale. - Edukimi për qytetari demokratike; - Edukimi për paqe; - Globalizimi dhe ndërvarësia; - Edukimi për medie; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> - Buletini i pjesëmarrjes - Lista e kontrollit; - Dosja e nxënësit; - Vëzhgimi i drejtpërdrejtë; - Vlerësimi përshkrues; - Projekte. 	<ul style="list-style-type: none"> - Njeriu dhe natyra; - Gjuhë shqipe; - Edukatë figurative; - Shoqëria dhe mjedisi; - Njohja e medias (përdorimi i medias për ta kuptuar botën përreth); - Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë); - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike; - Gjuha dhe shkathhtësitë e komunikimit; - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë; - Puna vullnetare.
Mediet	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon ndikimin e cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut. - Krijon porosi për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. - Argumenton brengosjen e njeriut për sasinë e mbeturinave. - Përpunon gjëra të ndryshme me materiale ricikluese. - Ndërgjegjësohet dhe informohet për sigurinë në internet. - Prezenton me anë të kompjuterit sigurinë e fëmijëve në internet. - Kupton rëndësinë e ruajtjes së të dhënave personale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë etj.). - Kupton që interneti përmban një sasi shumë të madhe informacioni për kërkimin dhe gjetjen e informacionit të kërkuar. - Argumenton rolin e radios, TV-së, medias sociale etj. 	<p>30. Shqetësimi i njeriut për sasinë e mbeturinave</p> <p>31. Përpunimi i gjërave të ndryshme me materiale ricikluese - Punimi i shportës me qese plastike</p> <p>32. Çantë e thurur me grep</p> <p>33. Siguria në internet</p> <p>34. Përdorimi i kompjuterit për sigurinë në internet</p> <p>35. Rëndësia e ruajtjes së të dhënave personale</p> <p>36. Kërkimi i informacioneve në internet</p> <p>37. Radioja, televizioni dhe mediet sociale</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi dhe të nxënësit bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Mësimdhënie përmes vëzhgimit, demonstrimit dhe eksperimentit; - Të mësuarit dhe të nxënësit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; - Ushtrimet me luajtje rolesh; - Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathtësive, puna interaktive; - Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale. - Edukimi për qytetari demokratike; - Edukimi për paqe; - Globalizimi dhe ndërvarësia; - Edukimi për medie; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm. 	10	<ul style="list-style-type: none"> - Buletini i pjesëmarrjes - Lista e kontrollit; - Dosja e nxënësit; - Vëzhgimi i drejtpërdrejtë; - Vlerësimi përshkrues; - Projekte. 	<ul style="list-style-type: none"> - Tekstet shkollore; - Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve; - Librat e punës; - Broshura; - Atlase; - Enciklopedi; - Softuera arsimorë; - Projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune - Gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë; https://emesimi.rks-gov.net/shq/

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:
Strukturon forma dhe figura të ndryshme nga llojet e letrës në mënyrë individuale dhe në grup.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II.5, III.4, V.9.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Strukturimi i formave dhe i figurave të ndryshme - Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan mënyrën e strukturimit të figurave gjeometrike nga letra;
- Dallon këndët, brinjët, kulmet dhe elementet e tjera të figurave gjeometrike;
- Formon me materiale të ndryshme strukturat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Letër me ngjyra, gërshtë, kompas, vizore, petëza me forma të ndryshme gjeometrike, laps, shkopinj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Matematikë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Bashkëbisedim

Shënohet në tabelë titulli “Figurat gjeometrike” dhe nxiten nxënësit të kujtojnë njohuritë paraprake. Nxënësit mendojnë për disa minuta. Pyesim:

- *Cilat figura gjeometrike i keni të njohura?*
- *Cilat janë elementet e figurave gjeometrike?*
- *Çfarë nevojitet për vizatimin e figurave gjeometrike?*
- *Si paraqiten këto figura në letër?*

Shpjegojmë që figurat gjeometrike paraqiten në rrafsh, prandaj janë dydimensionale.

Materialet dhe përpunimi i tyre

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Figurat gjeometrike;
- Trupat gjeometrikë;
- Shpalosja.

Fjalorthi:

- Paralelogram - figurë që i ka brinjët paralele.
- Projektion - paraqitje e objektit në rrafsh.
- Shpalosje - shtrirje e faqeve të trupit.

Materialet dhe përpunimi i tyre

* Strukturimi i formave dhe i figurave të ndryshme









Kur vizatojmë, shpesh paraqitet nevoja e vizatimit të figurave dhe të formave të ndryshme gjeometrike. E kur i ndërtojmë këto figura, përdorim drejtëzat paralele dhe normale, këndet e ngushta dhe të gjera, brinjët me madhësi të njëjtë ose të ndryshme, rrethin etj. Tani do të njihemi me disa prej këtyre ndërtimeve të figurave.

Figurat gjeometrike përbëhen prej brinjëve, kulmeve dhe këndeve që formojnë kulmet, ndërsa rrethi përcaktohet prej rrezes dhe qendrës së tij. Figurat gjeometrike paraqiten në rrafsh, andaj janë dydimensionale.

* Figurat gjeometrike

Më poshtë janë paraqitur figurat gjeometrike që përdoren më shpesh, së bashku me përbërësit e tyre. Të gjitha ndërtimet e tyre kryhen me laps, kompas dhe trekëndësha.

FORMAT E FIGURAVE GJEOMETRIKE

Katrori	Rrethi
4 brinjë të barabarta dhe 4 kënde të drejta. 	Lakore e mbyllur, pikat e së cilës kanë distancë të barabartë me qendrën. 
Peçkëndëshi	Trekëndëshi harabrinjës
5 brinjë dhe 5 kënde të barabarta. 	3 brinjë të barabarta, 3 kënde të barabarta nga 60°. 
Drejtëndëshi	Rombi
2 nga 2 brinjë të barabarta, 4 kënde të drejta. 	4 brinjë të barabarta, 2 nga 2 brinjë paralele, 2 kënde të gjera, 2 kënde të ngushta. 
Trapezoidi	Tetëkëndëshi
4 brinjë, 2 brinjë të barabarta, 2 brinjë të tjera paralele. 	8 brinjë dhe 8 kënde të barabarta. 

6



Detyrë:

Formoni, me ndihmën e shkopiñje, strukturat e dhëna më poshtë.

Trekëndëshi	Katrori	Paralelogrami	Trapezoidi
Rombi	Drejtëkëndëshi	Pesëkëndëshi	Gjashëkëndëshi
Bredhi	Flutura	Ylli	Zemra
Roboti	Fjolla e borës	Barka	Shtëpia

7



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Lexim i drejtuar

Përpara nxënësve paraqesim disa figura gjeometrike, të punuara paraprakisht. Kërkohe të mendojnë se cilat nga ato i hasin më shpesh në jetën e përditshme. Disa nxënës përshkruajnë figurat e paraqitura, duke emërtuar elementet përbërëse, si: brinjët, këndet, kulmet, sipërfaqja etj. Më pas nxënësit lexojnë në heshtje.

Kërkojmë nga nxënësit t'i evidentojnë të përbashkëtat dhe dallimet në mes të figurave, duke theksuar përbërësit e tyre.

Shpjegojnë se si mund të formohen këto figura. Dëgjohen me kujdes shpjegimet e nxënësve dhe plotësohen me informata shtesë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët

Punë praktike

Paraqiten përpara nxënësve struktura të ndryshme, të punuara me shkopiñje e të ngjitura në sipërfaqe të letrës. Nxënësit punojnë disa nga ato.

Trekëndëshi	Katrori	Paralelogrami	Trapezoidi
Rombi	Drejtëkëndëshi	Pesëkëndëshi	Gjashëkëndëshi

Bredhi	Flutura	Ylli	Zemra
Roboti	Fjolla e borës	Barka	Shtëpia

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin dhe formimin e strukturave të ndryshme me shkopiñje dhe dallimin e elementeve të figurave gjeometrike.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 6 - Lidh figurat gjeometrike me emërtimet e sakta.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:
Strukturon forma dhe figura të ndryshme nga llojet e letrës në mënyrë individuale dhe në grup.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5, III.4, V.9.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan mënyrën e strukturimit të trupave gjeometrikë nga letra;
- Dallon përbërësit (elementet) e trupave gjeometrikë;
- Gjen trupa gjeometrikë nga jeta e përditshme dhe i emërton ata.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Letër me ngjyra, gërshërë, kompas, vizore, trupa gjeometrikë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Matematikë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Bashkëbisedim

Shënohet në tabelë titulli “Trupat gjeometrikë” dhe nxiten nxënësit t’i kujtojnë njohuritë paraprake. Nxënësit mendojnë për disa minuta. Pyesim:

- *Cilët trupa gjeometrikë i keni të njohur?*
- *Si formohen trupat gjeometrikë?*
- *Cilat janë elementet, përbërësit e këtyre trupave gjeometrikë?*

Shpjegojmë që trupat gjeometrikë janë objekte tridimensionale, që përbëhen prej sipërfaqeve me vija dhe lakore (katrore, paralelograme, piramidale, cilindrike, konike, sferike etj.), të cilat pas kombinimit japin formën e dëshiruar.





Detyrë:

Nën secilin objekt shkruani numrin që përkon me figurën gjeometrike të dhënë si model.

 1. Sfera			
 2. Cilindri			
 3. Kubi			
 4. Koni			



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Udhëzohen nxënësit që në mënyrë individuale të lexojnë tekstin, më pas parashtrajnë kërkesat e mëposhtme:

- Sa faqe, kulme dhe brinjë ka kubi?
- Sa shkallë kanë këndet ndërmjet brinjëve?
- Si formohet cilindri?
- Trego dallimin në mes të piramidës katërfaqësore dhe trifuqësore.
- Trego elementet e konit.

Vazhdojmë edhe me trupat e tjerë gjeometrikë.

Në fund kërkojmë nga nxënësit të gjejnë sa më shumë objekte që kanë forma të trupave gjeometrikë dhe pastaj t'i emërtojnë.




Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Organizues grafik

Nxënësit në fletoret e tyre, në mënyrë të pavarur, plotësojnë organizuesin grafik. I njëjti paraqitet edhe në tabelë dhe plotësohet me mendimet e nxënësve.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin e strukturimit të trupave gjeometrikë, dallimin e elementeve të këtyre trupave dhe gjetjen e tyre në mjedisin që i rrethon.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 8 - Të emërtohen trupat gjeometrikë dhe elementet e tyre përbërëse.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 3

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:
Strukturon forma dhe figura të ndryshme nga llojet e letrës, në mënyrë individuale dhe në grup.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.8, III.1, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shpalosja e sipërfaqes së trupave - Punimi i kubit nga letra

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njeh sipërfaqet e ambalazheve të shpalosura;
 - Dallon dhe emërton pjesët përbërëse të këtyre sipërfaqeve;
 - Punon në mënyrë të pavarur kubin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kuti të ndryshme, kanaçe, fletë e hollë, vizore, laps i zi, ngjitës, gërshtë etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Matematikë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim-Demonstrim

Janë sjellë paraprakisht ambalazhe të ndryshme në klasë. Paraqiten ato para nxënësve dhe kërkohet nga ta që t'i emërtojnë. Më pas shpalosen në mënyrë që nxënësit të njihen më mirë me të gjitha pjesët përbërëse të tyre.




Më pas paraqiten disa raste të zhvillimit të sipërfaqeve për: kubin, prizmin katërfaqësor, piramidën katërfaqësore, prizmin trefaqësor, konin dhe cilindrin.



★ Punimi i kubit nga letra

Mjetet që nevojiten për ta punuar kubin nga letra janë: gjysmëkartoni, vizorja, lapsi i zi, lapsat me ngjyra, ngjitësi, gërshërët.


1 Fillojmë ta vizatojmë sipërfaqen e kubit.



2 I vizatojmë edhe shtesat e kulmeve, për të ngjitur faqet e kubit. E presim kubin me gërshërë.



3 I palosim kulmet e kubit dhe i lyejmë ato me ngjitës.



4 Ja se si duket kubi në fund: pamja përfundimtare e kubit shihet më poshtë.



9



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Punë praktike

Njoftojmë nxënësit me mjetet e punës që nevojiten dhe njihen me hapat e realizimit të kubit.



1. Fillojmë të vizatojmë sipërfaqen e kubit.



2. I vizatojmë edhe shtesat e teheve, për të ngjitur faqet e kubit. Bëjmë prerjen e kubit me gërshërë.



3. Bëjmë palosjen e teheve të kubit. Lyejmë tehet me ngjitës.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Turi i galerisë

Punimet e nxënësve ekspozohen në një kënd të klasës. Lihen të lirë të vëzhgojnë punimet e

shokëve/shoqeve. Diskutojnë dhe i parashtrojnë pyetje njëri-tjetrit.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen dhe emërtimin e pjesëve përbërëse të ambalazheve dhe punimin e kubit nga letra.

Detyrë:

Libri bazë, faqe 10 - Të punohen nga letra piramida katërfaqësore dhe cilindri.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Modelon me qepje, thurje dhe qëndisje.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.8, III.2, III.5, V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Modelimi me qepje, thurje dhe qëndisje

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan procesin e qepjes, thurjes dhe qëndisjes;
 - Modelon sende përmes qepjes, thurjes dhe qëndisjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Veshje të ndryshme, letër, copëza tekstili, gërshërë, ngjitës etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Bashkëbisedim

Janë sjellë paraprakisht veshje të ndryshme, sende të qëndisura dhe të thurura në klasë. Pyesim nxënësit:

- *E dini si fitohen këto sende?*
- *Cilat veprimtari duhet të kryhen që të fitohen këto produkte?*
- *Tregoni për rëndësinë e tyre.*

Nxiten nxënësit të vëzhgojnë veshjet e shokëve dhe shoqeve dhe të tregojnë cila veprimtari është përdorur gjatë punimit të tyre.

Shpjegohet se qepja, thurja dhe qëndisja janë përdorur që nga kohët e lashta për krijimin e veshjeve.

Materialet dhe përpunimi i tyre

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Qepja;
- Qëndisja;
- Thurja;
- Gjergjeft;
- Trikoja;

Fjalorthi:

- Fill leshi - fije leshi.
- Sintetikë - material artificial.
- Ildisja - loj i qepjes.

* Modelimi me qepje, thurje dhe qëndisje

Veshjet tona përbëhen prej materialeve të ndryshme të tekstilit. Fillimisht, materialet priten në copa. Me anë të modelimit qepen, e disa prej tyre edhe mund të qëndisen. Kështu, ato marrin forma të caktuara, të cilat janë të gatshme për t'u veshur. Gjithashtu, ka materiale (fill leshi, pambuku, sintetikë etj.) prej të cilave thuren xhemperë, qilima, por edhe gjëra të tjera artizanale. Sot, qepja kryesisht bëhet me makina për qepje, por edhe qepja me dorë është e pranishme.

* Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme

Kur të qepim me dorë, është shumë e rëndësishme mënyra se si i mbajmë gjilpërën dhe perin. Sigurisht, është shumë më e lehtë dhe më e shpejtë qepja me makinën qepëse, por në disa raste, qepja me dorë është e nevojshme.

Praktika luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e shkathësisë. Sa më shumë që ta praktikojmë qepjen, aq më të shkathët bëhemi. Prandaj, para se të qepim ndonjë veshje, zgjedhim një copë pëlhurë, për të praktikuar fillimisht me të.




Mjetet dhe materiali i nevojshëm për qepje me dorë janë:

- Gjilpëra për qepje me dorë;
- Cishtëza;
- Gërshërë;
- Metri;
- Peri.



* Llojet e qepjes me dorë janë:

- **Qepja e rrallë (Ildisja)** - shërben për t'i qepur përkohësisht pëlhurat që vendosen njëra mbi tjetrën. Fija e perit shkon gjithnjë përpara, duke përshkuar pëlhurat herë përfundi, herë përsipër.



Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Qepja;
- Qëndisja;
- Thurja;
- Gjershefi;
- Trikoja;

Fjalorthi:

- Fill leshi - fije leshi.
- Sintetikë - material artificial.
- Ilidjsja - lloj i qepjes.

*** Modelimi me qepje, thurje dhe qëndisje**

Veshjet tona përbëhen prej materialeve të ndryshme të tekstilit. Fillimisht, materialet priten në copa. Me anë të modelimit qepen, e disa prej tyre edhe mund të qëndisen. Kështu, ato marrin forma të caktuara, të cilat janë të gatshme për t'u veshur. Gjithashtu, ka materiale (fill leshi, pambuku, sintetikë etj.) prej të cilave thuren xhemperë, qilima, por edhe gjëra të tjera artizanale. Sot, qepja kryesisht bëhet me makina për qepje, por edhe qepja me dorë është e pranishme.

*** Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme**

Kur të qepim me dorë, është shumë e rëndësishme mënyra se si i mbajmë gjilpërën dhe perin. Sigurisht, është shumë më e lehtë dhe më e shpejtë qepja me makinën qepëse, por në disa raste, qepja me dorë është e nevojshme. Praktika luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e shkathtësisë. Sa më shumë që ta praktikojmë qepjen, aq më të shkathtët bëhemi. Prandaj, para se të qepim ndonjë veshje, zjedhim një copë pëlhurë, për të praktikuar fillimisht me të.




Mjetet dhe materiali i nevojshëm për qepje me dorë janë:

- Gjilpëra për qepje me dorë;
- Gishtëza;
- Çërshërët;
- Metri;
- Peri.



*** Llojet e qepjes me dorë janë:**

- **Qepja e rrallë (Ilidjsja)** - shërben për t'i qepur përkohësisht pëlhurat që vendosen njëra mbi tjetrën. Fija e perit shkon gjithnjë përpara, duke përshkuar pëlhurat herë përfundit, herë përsipër.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Lexim i drejtuar**

Lexohet teksti në librin e nxënësit dhe parashtrahet pyetje:

- Çka nënkuptoni me fjalën modelim?
- Keni modeluar ju ndonjë veshje ndonjëherë?
- Kush e realizon veshjen pas modelimit të saj?
- Po veshje të thurura keni në dollapin tuaj?
- Si punohen këto veshje, me dorë apo me makineri?
- Përshkruani procesin e modelimit, qepjes, thurjes dhe qëndisjes.

Modelimi është vizatim në bazë të të cilit krijohet një veshje e re.

Qepja është bashkimi i pjesëve të prera, kopsave ose dekoreve të ndryshme.

Thurja është gërshetimi i fijeve të perit dhe krijimi i produkteve të ndryshme nga to.

Qëndisja është zbukurimi i pëlhurave ose veshjeve.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët
Punë praktike - Vizualizim**

Nxënësve u shpërndahen fletë të formatit A4 dhe kërkohet që të modelojnë një veshje, apo send që do ta realizojnë më vonë përmes qepjes, thurjes apo qëndisjes.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin dhe modelimin e sendeve përmes qepjes, thurjes ose qëndisjes.

Detyrë:

Të realizohet modeli i punuar në klasë përmes qepjes, thurjes apo qëndisjes.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Dallon llojet e qepjes dhe i praktikon në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, III.4, III.7, V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Njeh mjetet dhe materialet që nevojiten për qepje;
- Dallon llojet e qepjes që praktikohen në jetën e përditshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjilpërë, penj, gërsdhërë, gishtëza, fletë A4 etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Bashkëbisedim

Parashitje pyetje:

- Çfarë bëni nëse ju këputet kopsa nga këmisha ose ju shqepen rrobat?
- Kush i qep ato? Pse?
- Si bëhet qepja me dorë ose makinë qepëse?

Pasi të dëgjohen mendimet e nxënësve, kërkohet që të shënojnë në fletore mjetet dhe materialet që nevojiten për të realizuar qepjen.

Ndërkohë shpjegohet që është shumë më e lehtë dhe më e shpejtë të qepësh me makinën qepëse, por ka edhe disa pjesë gjatë punës kur qepja me dorë është e nevojshme.

Materialet dhe përpunimi i tyre

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Qepja;
- Thurja;
- Trikoja;
- Qëndisja;
- Gjersjefi.

Fjalorthi:

Fill leshtë - fije leshtë.
 Sintetikë - material artificial.
 Ildisja - lloj i qepjes.

* Modelimi me qepje,thurje dhe qëndisje

Veshjet tona përbëhen prej materialeve të ndryshme të tekstilit. Fillimisht, materialet priten në copa. Me anë të modelimit qepen, e disa prej tyre edhe mund të qëndisen. Kështu, ato marrin formë të caktuara, të cilat janë të gatshme për t'u veshur. Gjithashtu, ka materiale (fill leshtë, pambruk, sintetikë etj.) prej të cilave thuren xhemperë, qifima, por edhe gjëra të tjera artizanale. Sot, qepja kryesisht bëhet me makinë për qepje, por edhe qepja me dorë është e pranishme.

* Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme

Kur të qepim me dorë, është shumë e rëndësishme mënyra se si i mbajmë gjilpërën dhe perin. Sigurisht, është shumë më e lehtë dhe më e shpejtë qepja me makinën qepëse, por në disa raste, qepja me dorë është e nevojshme. Praktika luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e shkathësisë. Sa më shumë që ta praktikojmë qepjen, aq më të shkathët bëhemi. Prandaj, para se të qepim ndonjë veshje, zgjedhim një copë pëlhurë, për të praktikuar fillimisht me të.




Mjetet dhe materiali i nevojshëm për qepje me dorë janë:

- Gjilpëra për qepje me dorë;
- Gishtëza;
- Gërsdhërë;
- Metri;
- Peri.




* Llojet e qepjes me dorë janë:

- Qepja e rrallë (Ildisja) - shërben për t'i qepur përkohësisht pëlhurat që vendosen njëra mbi tjetrën. Fija e perit shkon gjithnjë përpara, duke përshkuar pëlhurat herë përfundit, herë përsëri.



Materialet dhe përpunimi i tyre

2



Qepja zigzage – punohet duke e kapur skajin e pëllhurës me disa fije të pëllhurës bazë përmes gjilpërës. Nuk lejohet shtrëngimi i perit, në mënyrë që ana e mbarë e tij të mos dallohet. Këtë mënyrë qepjeje e aplikojmë zakonisht kur dëshirojmë t'i qepim këmbëzat e pantallonave ose të fundeve të fustaneve.

4




Qepja paralele – punohet përtë penguar daljen e fijeve nga pëllhura dhe kështu e ruan nga prishja. Kjo qepje punohet poshtë-lart, duke e mbështjellë perin në gjilpërë në skajin e pëllhurës.

3



Qepja me kthim – punohet duke përshtuar pëllhurat që bashkohen përfundit e përsipër, por gjithnjë duke bërë një therje para dhe një kthim prapa.

5



Qepja e pullës – punohet duke zbatuar këta hapa:

1. Përshkohet peri në gjilpërë.
2. Shpaloset një gjatësi e perit, shkëputet nga fytëza dhe lidhet rreth në mbarim.
3. Rrjet në vrimë të pullës, pastaj në vrimën tjetër dhe përshkohet në pëllhurë.
4. Hapi 3 përsëritet derisa qepja të jetë e fortë.
5. Në fund, gjilpëra duhet të dalë në anën e brendshme të pëllhurës dhe të përshkohet disa herë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mësimdhënia e ndërsjelltë**

Nxënësit ndahen në grupe. Udhëzohen që secili grup të lexojë pjesën e caktuar. Një anëtar i grupit do të shpjegojë pjesën e lexuar, duke u bazuar në kërkesat e dhëna:

Mjetet dhe materiali i nevojshëm për qepje:

- Cilat mjete dhe materiale përdoren për qepjen me dorë dhe me makinë qepëse?

Llojet e qepjes me dorë

- Cilat janë llojet e qepjes me dorë? Kur praktikohen secila nga këto qepje?

Qepja e pullës

- Numëroni hapat për qepjen e pullës.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Tabela e koncepteve**

Pasi përfundon puna në grupe, plotësohet me gjithë klasën tabela e përgatitur. Nxënësit fokusohen te llojet e qepjeve.

Qepja e rrallë	Si realizohet?
	Përse shërben?
Qepja me kthim	Si realizohet?
	Përse shërben?
Qepja paralele	Si realizohet?
	Përse shërben?
Qepja zigzage	Si realizohet?
	Përse shërben?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e mjeteve që shërbejnë për qepje dhe dallimin e llojeve të qepjes.

Detyrë:

Me ndihmen e një trrituri, të praktikohen llojet e qepjes të mësuara në klasë.

Reflektim për rrezdhen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Dallon llojet e qepjes dhe i praktikon në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.4, V.9, VI.2

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme - Veprimtari praktike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Siguron mjetet dhe materialet e nevojshme për punë;
- Përdor me kujdes mjetet e punës;
- Praktikon qepjen fillestare.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjilpërë, penj, gërshtë, gishtëza etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënësit

Mendo - Krijo dyshe - Diskuto

Ora e mësimi fillon me një veprimtari të thjeshtë: Nxënësit do të mendojnë dhe shkruajnë nga dy fjali për llojet e qepjes me dorë dhe qepjen e pullës.

Fillimisht diskutojnë në dyshe, më pas shpjegojnë para klasës.

Pasi të kryhet kjo veprimtari, kontrollohen mjetet dhe materialet që do të përdoren. Gjithashtu, përgatitjet sipërfaqja e punës.



● **Materialet dhe përpunimi i tyre**

- ★ Llojet e qepjes dhe praktikimi në jetën e përditshme
- ★ Modelimi me qepje,thurje dhe qëndisje



Detyrë:

Punoni çizmen nga pëlhura. Qepja le të jetë paralele, ndërsa pulla le të qepet përsipër njërisë anë të çizmes, siç është dhënë në figurë.



Detyrë:

Praktikoni thurjen me një këmbëz. Punoni në grupe të vogla pjesën e trikos.



Detyrë:

Qëndisni emrin tuaj sipas dëshirës.

10



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar**

- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale në grupet përkatëse, duke ndjekur udhëzimet hap pas hapi.
- Secili grup realizon një lloj të qepjes, të cilin paraprakisht e kanë praktikuar edhe në shtëpi.
- Nxënësit që tregohen më të shkathët ndihmojnë shokët dhe shoqet, gjithmonë duke pasur kujdes gjatë përdorimit të mjeteve të punës.
- Në fund, të gjithë nxënësit do të qepin nga një pullë, duke u bazuar në hapat e realizimit.
- 1. Përshkohet peri në gjilpërë, lidhet nyja.
- 2. Futet në vrimë të pullës, pastaj në vrimën tjetër dhe përshkohet në pëlhurë.
- 3. Disa herë përsëritet hapi 2, derisa qepja të jetë e fortë.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Dil rrotull - Fol rrotull**

Punimet e nxënësve ekspozohen në këndin e artit. Lihen të lirë nxënësit të vëzhgojnë dhe krahasojnë.

sojnë punën e tyre me të shokëve a shoqeve. Parashtojnë pyetje dhe japin përgjigje për ecurinë e punës dhe vështirësitë gjatë praktikimit të qepjes.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për sigurimin e mjeteve të punës, kujdesin gjatë qepjes dhe praktikimin e qepjes.

Detyrë:

Faqe 10, Fletore pune - Të realizohet modeli i çizmes prej pëlhure me qepje paralele.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Modelon me qepje, thurje dhe qëndisje.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5, III.4, III.5, III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Thurja me një kërrabëz

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Njeh mjetet dhe materialet e nevojshme për punë;
- Përshkruan fazat e thurjes me një kërrabëz;
- Praktikon thurjen me një kërrabëz.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kërrabëza, gërshërët dhe një lëmsh i vogël (pambuk, fill leshi ose akril etj.)

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë


Vëzhgim - Demonstrim

Përpara nxënësve paraqesim mjetet dhe materialet e nevojshme për thurje me një kërrabëz.

Pyesim:

- *I keni parë më heret këto mjete?*
- *E dini se për çfarë përdoren?*

Më pas demonstruam thurjen hap pas hapi, duke dhënë sqarimet e nevojshme. Procesi përsëritet disa herë derisa të gjithë nxënësit ta kenë kuptuar.




Materialet dhe përpunimi i tyre

3



3 Pastaj, e lironi perin nga gishdi tregues dhe e formojmë vegëzën e parë.

4



4 E vendosim kërrabëzën në po të njëjtën vegëz.

5




5 E shtrëngojmë vegëzën për kërrabëzën dhe fillojmë të formojmë vegëzën e radhës.

6




6 Vegëzën e radhës e formojmë duke e rrotulluar kërrabëzën rreth perit dhe duke e tërhequr me majën e saj.

7



7 Perin e kapur me majën e kërrabëzës e nxjerrim nëpërmjet vegëzës së formuar më parë.

8



8 Këshaj i formojmë edhe vegëzat e tjera me radhë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar**

- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale duke ndjekur udhëzimet hap pas hapi në tekstin e tyre përthurjen e një trikoje.
- Nxënësit që tregohen më të shkathët ndihmojnë shokët dhe shoqet, gjithmonë duke i kushtuar kujdes përdorimit të mjeteve të punës.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Në fund, rikujtojmë mjetet dhe materialet e punës dhe hapat sipas të cilëve është realizuar punimi. Nxënësit punojnë në dyshe.

Çfarë mjete përdoren përthurjen me dorë?	Me sa kërrabëza mund të thuret një shall?	Të përshkruhen hapat e thurjes me një kërrabëz.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e mjeteve dhe materialeve, përshkrimin e hapave dhe realizimin e punës me një kërrabëz.

Detyrë:

Të vazhdohet realizimi i shallit të thurur me një kërrabëz.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 8

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Modelon me qepje, thurje dhe qëndisje.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5, III.4, III.5, III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Thurja me dy kërrabëza

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Njeh mjetet dhe materialet e nevojshme për punë;
- Përshkruan fazat e thurjes me dy kërrabëza;
- Praktikon thurjen me dy kërrabëza.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Dy kërrabëza, gërshërë dhe një lëmsh i vogël.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë


Vëzhgim - Demonstrim

Përpara nxënësve paraqesim mjetet dhe materialet e nevojshme për thurje me dy kërrabëza.

Pyesim:

- *I keni parë më heret këto mjete?*
- *E dini se për çfarë përdoren?*

Më pas demonstrojmë thurjen hap pas hapi, duke dhënë sqarimet e nevojshme. Procesi përsëritet disa herë derisa të gjithë nxënësit ta kenë kuptuar.



Materialet dhe përpunimi i tyre

3



• Kërrabëzën dhe njërin skaj të perit e mbajmë me njërin dorë, ndërsa rreth gishtit të madh të dorës tjetër e mbështjellim skajin tjetër të perit.

4




• E vendosim kërrabëzën brenda rrethit të vegëzës dhe e tërheqim gishtin e madh.

5



• I përsërisim hapat 3 dhe 4, për t'i formuar vegëzat e tjera.

6



• Thurjen e vazhdojmë duke e përdorur edhe një kërrabëz të dytë.

7



• Bëjmë një rrotullim të perit rreth kërrabëzës së majtë.

8



• Vegëzën e hartim në kërrabëzën e djathtë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar**

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale, duke ndjekur udhëzimet hap pas hapi në tekstin e tyre për thurjen e një trikoje.

Nxënësit që tregohen më të shkathët ndihmojnë shokët dhe shoqet, gjithmonë duke i kushtuar kujdes përdorimit të mjeteve të punës.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Në fund, rikujtojmë hapat sipas të cilëve është realizuar punimi. Nxënësit punojnë në dyshe.

Të përshkruhen hapat e thurjes me një kërrabëz

- Cilat mjete nevojiten për thurje me dy kërrabëza?
- Cilët hapa duhen ndjekur?
- ...

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e mjeteve dhe materialeve, përshkrimin e hapave dhe realizimin e punës me dy kërrabëza.

Detyrë:

Të vazhdohet realizimi i trikos së thurur me dy kërrabëza.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 9

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Modelon me qepje, thurje dhe qëndisje.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5, III.4, III.5, III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qëndisja

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Njeh mjetet dhe materialet e nevojshme për punë;
- Dallon disa lloje të qëndisjes;
- Praktikon disa lloje të qëndisjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjergjef, gjilpërë, gërshtë dhe fije me ngjyra të ndryshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Vëzhgim - Demonstrim

Përpara nxënësve paraqesim mjetet dhe materialet e nevojshme për thurje me dy kërrabëza.

Pyesim:


- *I keni parë më heret këto mjete?*
- *E dini se për çfarë përdoren?*

Më pas demonstrojmë thurjen hap pas hapi, duke dhënë sqarimet e nevojshme. Procesi përsëritet disa herë derisa të gjithë nxënësit ta kenë kuptuar.

● **Materialet dhe përpunimi i tyre**

★ **Qëndisja në formë të pjerrët**

Shihni qëndisjen në formë të pjerrët përmes hapave të punës të dhënë më poshtë:




Punim me qëndisje të pjerrët

18

Qëndisja me kthim prapa

Shihni qëndisjen me kthim prapa përmes hapave të punës të dhënë më poshtë:



Qëndisja zinxhërore


Shihni qëndisjen zinxhërore përmes hapave të punës të dhënë më poshtë:



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar**

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale, duke ndjekur udhëzimet hap pas hapi në tekstin e tyre për qëndisje.

Demostrohen disa lloje të qëndisjes, ndërkohë nxënësit praktikojnë qëndisjen në formë të pjerrët.




Nxënësit që tregohen më të shkathët ndihmojnë shokët dhe shoqet, gjithmonë duke i kushtuar kujdes përdorimit të mjeteve të punës.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Dil rrotull - Fol rrotull**

Nxënësit vazhdojnë me praktikimin edhe të ndonjë forme tjetër të qëndisjes.

Punimet e tyre ekspozohen në një kënd të klasës. Nxënësit janë të lirë të vëzhgojnë dhe krahasojnë punën e tyre me punimet e shokëve/shoqeve të klasës. Parashtrajnë pyetje dhe diskutojnë për mënyrën e realizimit të punimeve.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e mjeteve dhe materialeve, dallimin e llojeve të qëndisjes dhe praktikimin e ndonjëres nga këto forma.

Detyrë:

Faqe 11 Fletore pune - Qëndisni në pëlhurë fjollën e borës si në figurë. Qëndisja le të jetë në formë të pjerrët.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Ekspozon punimet e tij apo saj në klasë apo shkollë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.8, III.1, IV.3, V.8, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ekspozimi i punimeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson punën artizanale;
- Njeh vlerat e veshjeve kombëtare;
- Analizon punën praktike gjatë ekspozitës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ngjitës, kapëse metali, mbajtëse, fotografi, ilustrime, veshje me motive popullore etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Vëzhgim - Realizim

Realizimi i ekspozitës bëhet duke ndjekur hap pas hapi planifikimet paraprake. Ekspozita realizohet në hapësirat e shkollës. Me kohë njoftohet drejtorja dhe nxënësit paraprakisht ndahen në grupe, duke marrë përsipër detyra të caktuara. Punimet e grumbulluara vëzhgohen me kujdes, përzgjidhen dhe dërgohen në këndin e ekspozitës.



Materialet dhe përpunimi i tyre

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Veshje kombëtare;
- Mjete pune artizanale;
- Ushqime tradicionale.

Fjalorthi:

- Artizanale - e punuar me dorë.
- Kostume - veshje.
- Dekorime - zbukurime.

* Ekspozimi i punimeve

Organizoni një ekspozitë për trashëgiminë kulturore tonën, ku të mbledhni fotografi të ndryshme të veshjeve tona kombëtare prej viseve të ndryshme, kostume të punuara me dorë, qëndisje dhe dekorime të tjera, ushqime tradicionale, si dhe mjete pune artizanale që janë përdorur në të kaluarën. Ekspozitën mund ta hapni në ditën e shkollës.



Pyetje:

- Cilat veshje tradicionale njihni ju?
- Po mjete pune artizanale, a keni në shtëpi? Kush kujdeset për to?
- Grumbulloni fotografi nga e kaluara e familjes dhe vendosini në një album.
- Përgatitni një ekspozitë me veshje tradicionale, mjete pune artizanale dhe fotografi të veshjeve kombëtare.
- A ka raste kur i përdorim edhe sot veshjet tradicionale?

Projekt hulumtues

Hulumtoni në internet për veshje tradicionale të kombësive të tjera të Ballkanit.

21



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Punë e drejtuar

Në ekspozitë vendosen punimet e nxënësve, të modeluara, të qepura me gjilpërë, të qëndisura, të thurura me motive të ndryshme.

Gjithashtu, mund të mbledhën fotografi nga veshjet tona kombëtare prej viseve të ndryshme, kostume të punuara me dorë, qëndisje dhe dekorime të tjera, ushqime tradicionale, si dhe mjete pune artizanale që janë përdorur në të kaluarën. Secili grup kryen detyrën e përcaktuar më parë.

1. Përzgjedhja e punimeve;
2. Ngjitja dhe vendosja e punimeve;
3. Prezantimi dhe sqarimi sa më i bukur i punimeve.



Përforsimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Dil rrotull - Fol rrotull

Punimet e ekspozuara vizitohen edhe nga nxënësit e tjerë. Ata janë të lirë të vëzhgojnë dhe parashtojnë pyetje, si dhe të japin përgjigje për ecurinë e punës dhe realizimin e punimeve,

veçanërisht për punimet me motive kombëtare. Shpjegojnë se cilat veprimtari të punës së dorës janë përdorur gjatë realizimit të tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për vlerësimin e punës së dorës, veshjeve me motive kombëtare dhe analizimin, prezantimin dhe sqarimin e punimeve në ekspozitë.

Detyrë:

Hulumtoni në internet për veshje tradicionale të zonave të ndryshme shqiptare. Krijoni një album.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënët të temës:
Praktikon hekurin për hekurosje në mënyrë të drejtë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.4, V.8, VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i aparateve dhe i veglave elektrike

- Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:
- Emërton aparatet elektrike dhe tregon funksionin e tyre;
- Përshkruan procesin e hekurosjes;
- Përdor me kujdes hekurin gjatë hekurosjes;
- Praktikon në mënyrë të drejtë hekurin gjatë hekurosjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi dhe ilustrime, flipchart, hekur për hekurosje, pecetë etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Nxitet të menduarit e nxënësve duke parashtruar pyetjen: Çfarë dini për elektroshtëpiake, aparatet dhe veglat elektrike? Mundësisht paraqesim fotografi ose përmes projektorit pamje të këtyre veglave shtëpiake. Nxënësit mendojnë për disa minuta dhe thonë gjithçka që dinë. Më pas mendimet e tyre shënohen në faqen përkatëse në fletore pune.

Njohja me rreziqet
Fjalë dhe shprehje kyçe:
- Hekur për hekurosje;
- Higjienë.
Fjalorthi:
Hekurosje - drejtimit i rrobave.

Njohja me rreziqet

Përdorimi i aparateve dhe i veglave elektrike



Për mënyrën se si jetojmë sot, është i pashmangshëm përdorimi i aparateve të ndryshme elektrike. Këtë e bëjmë për përgatitjen e ushqimit, për mbajtjen e higjienës, për komunikim etj.

Për higjienën personale, është shumë e rëndësishme, ndër të tjera, veshja e rrobave të pastra. Rrobat i lajmë, i dezinfektojmë dhe pastaj i hekurosim. Pajisja që përdoret për hekurosjen e rrobave quhet hekur dhe ai funksionon përmes rrymës elektrike, pra është pajisje elektrike.

Para se ta lidhim hekurin për hekurosje me rrymë elektrike, duhet të kujdesemi që:

- rrobat për hekurosje t'i vendosim në vend të përshtatshëm, siç është dërrasa e hekurosjes, për siguri dhe shtrirje sa më të mirë të tyre;
- hekurit të jetë i pastër, sepse në të kundërtën mund ta dëmtojë veshjen gjatë hekurosjes;
- të jetë i mbushur me ujë, sepse uji shndërrohet në avull, që ndihmon në hekurosje më të mirë dhe e ruan ngjyrën e rrobave;
- kabllin e hekurit të mos jetë i dëmtuar.

Kur e fusim kabllin në prizë, e përshtasim temperaturën në rregullator varësisht se çfarë materiali kemi për të hekurosur. Sa më i hollë të jetë materiali, përdoret temperaturë më e ulët dhe anasjelltas, sa më i trashë, temperatura duhet të jetë më e lartë.

Pasi t'i hekurosim rrobat, duhet të kujdesemi që:

- ta heqim kabllin e hekurit nga priza e rrymës;
- ta vendosim hekurin në mënyrë vertikale, që të mos digjet materiali mbi të cilin po hekurosim.

Hekurosjë mund të mësohet dhe të praktikohet vetëm nën mbikëqyrjen e prindit ose të një të rrituri.





Mos harro!

Hekuri është aparat elektrik që shërben për hekurosjen e rrobave dhe, si i tillë, energjinë elektrike e shndërron në nxehtësi për të na mundësuar hekurosjen. Duhet të jemi të kujdesshëm gjatë dhe pas hekurosjes se ku e vendosim hekurin sa është i nxehtë. Kujdes të veçantë duhet të tregojmë edhe ndaj kablrit, që të mos jetë i dëmtuar (i ndrydhur apo i zhveshur).



Pyetje:

- Pasi i lajmë dhe i thajmë rrobat, ato janë të ndrydhura. Çfarë duhet të bëjmë që t'i drejtojmë ato?
- Pse duhet pasur kujdes para se ta ndezim hekurin e hekurosjes?
- Pasi të përfundojmë hekurosjen e rrobave, si duhet të veprojmë me hekurin?



Nxiten nxënësit të përmendin sa më shumë elektroshtëpiake, vëmë theksin te hekuri për hekurosje. Paraqesim hekurin para nxënësve, shpjegohet funksioni i tij dhe pjesët përbërëse.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mësimdhënia e ndërsjelltë**

Nxënësit ndahen në tri grupe të mëdha. Udhëzohen që secili grup të lexojë pjesën e caktuar. Një anëtar i grupit do të shpjegojë pjesën e lexuar, duke u bazuar në pyetjet:

Përshkrimi i procesit të hekurosjes - Pasi bëjmë larjen dhe tharjen e rrobave, ato janë të ndrydhura, çfarë duhet bërë që ato të duken bukur? Si kryhet ky proces?


Kujdesi gjatë hekurosjes - Për çfarë duhet pasur kujdes para se ta ndezim hekurin për hekurosje? Po gjatë hekurosjes, si duhet të veprojmë? Pasi të përfundojmë me hekurosje, si duhet të veprojmë më pas me hekurin?

Përdorimi i drejtë i hekurit - Cilat janë veprimet e duhura gjatë hekurosjes? Si duhet ta përdorim hekurin në mënyrë të drejtë?



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Veprimtari praktike**

Fillimisht demonstron hekurosja nga vetë mësimdhënësi, më pas disa nxënës praktikojnë hekurosjen e një pecete. Procesi i hekurosjes vëzhgohet nga mësimdhënësi.



Emërtimi i aparatit	Si funksionon?	Për çfarë e përdorim? Cilat janë rreziqet?
Hekuri për hekurosje		

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin e elektroshtëpiakeve, përshkrimin e fazave të hekurosjes dhe përdorimin e drejtë dhe të sigurt të hekurit.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 15 - Hekurosni me ndihmën e prindërve një këmishë dhe përshkruani ecurinë e këtij procesi.

Reflektim për rrezdhen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathhtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Njohja nga rreziqet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përdor veglat shtëpiake (përzierës, shtrydhëse frutash, shporet elektrik), duke përgatitur prodhime të ndryshme ushqimore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1, III.4, IV.7, V.9.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përgatitja e supës kremoze dhe kujdesi nga rreziqet e mundshme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton aparatet elektrike që përdoren për gatim;
- Përdor me kujdes pajisjet elektrike gjatë gatimit;
- Përgatit supë të shëndetshme me perime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, ilustrime, perime, përzierës, shtrydhëse frutash, shporet elektrik, thikë, toster etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Paraqiten përpara nxënësve fotografi të elektroshtëpiakeve që përdoren për gatim, të cilat shumica i kemi në shtëpi. Me nxënësit diskutojmë për elektroshtëpiaket që i kemi në kuzhinat tona, tregojnë si i përdorin ato dhe për çfarë i përdorin, a i lejojnë prindërit që në mënyrë të pavarur t'i përdorin këto mjete. Shpjegojnë pse është e rrezikshme që këto mjete të përdoren pa prezencën e të rriturve.

Njohja me rreziqet

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Pajisje elektrike për ushqim;
- Kujdesi nga rreziqet.

Fjalorthi:


Supë kremoze - supë e trashë.
Toster - aparat elektrik.

★ Përgatitja e supës kremoze dhe kujdesi nga rreziqet e mundshme

Ushqimi është një ndër faktorët kryesorë të jetës sonë. Prandaj, përzgjedhja e asaj çfarë konsumojmë ka rëndësi për shëndetin tonë. Supat e gatuar me perime të llojllojshme, të pasura me shumë vitamina dhe minerale të domososhme për organizmin tonë, mund të jenë pjesë e përditshme e menisë ushqimore.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që të aftësohemi dhe të mësohemi të gatuajmë vetë. Gjatë përgatitjes na duhen pajisjet elektrike, të cilat, paraprakisht, duhet t'i mësojmë mirë se si t'i përdorim për t'i shmangur rreziqet e mundshme.

- ★ Në të majtë të diagramit shkruani frutat e pëlqyera, në të djathtë perimet, ndërsa në mes të përbashkëtat që kanë.




Tani, me perimet më të pëlqyera nga ju do të përgatisim një supë kremoze. **A e dini se sa e shëndetshme është ajo?**



Receta e supës kremoze:

- | | |
|-----------------|-------------------------|
| 2 karota; | 500 ml qumësht; |
| 2 patate; | 1 lugë gjalpë; |
| 2 lugë bizele; | mëlmesa sipas dëshirës. |
| erëza e mentës; | |



Përgatitja:
Fillimisht, i qërojmë patatet dhe karotat. Pasi t'i lajmë, i imtësojmë me bluese elektrike ose edhe me thikë. Gjatë këtij veprimi duhet të kemi kujdes që të mos lëndohemi.
Më pas, i vendosim perimet në një enë me ujë dhe i lëmë që të zihen mbi shporetin elektrik për 10 minuta. Sigurohemi që ena të mos jetë e lagur, për shkak se shporetit është pajisje elektrike.

Pas zierjes, e kullojmë ujin dhe në enën tjetër vendosim një lugë gjalpë dhe një lugë miell; i përziejmë derisa të treten dhe ua shtojmë 500 ml qumësht. I përziejmë përsëri, derisa masa të jetë e njëjtë. Tani i shtojmë perimet e ziera dhe i përziejmë në temperaturë të ulët. Në fund shtojmë mëlmesa sipas dëshirës. Supa tashmë është e gatshme për t'u pirë. Atë mund ta përcjellim me feta buke të nxeitura në toster. Duhet të kemi kujdes nga nxehtësia e madhe që liron tosteri gjatë përdorimit.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Punë e drejtuar**

Në kuzhinën e shkollës apo në një kënd të përshtatshëm në klasë vendosen perimet e pastruara. Kërkohet që ato të qërohen, pastaj, për t'i imtësuar, mund të vendosen në bluese elektrike ose mund të imtësohen me thikë me kujdes të shtuar. Duke ndjekur udhëzimet në tekst dhe duke u bazuar te receta, përgatitet supa e cila shërbehet me bukë të thekur.

Për thekjen e bukës përdoret thekësi i bukës ose tostera. Pas përgatitjes së supës, nxiten nxënësit të plotësojnë ushtrimin, duke emërtuar pemët dhe perimet e preferuara dhe tregojnë se çfarë kanë të përbashkët.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Nxënësit e pavarur punojnë në fletoret e tyre.

- Pas higjienës, nga çfarë tjetër varet shëndeti i mirë i njeriut?
 - Cilët janë përbërësit e supës kremoze dhe për çfarë duhet pasur kujdes gjatë përgatitjes me stufë dhe vegla elektrike?
 - Si vihet tosteri në funksion? Për çfarë duhet të kemi kujdes gjatë përdorimit?
- Disa nxënës lexojnë përgjigjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin dhe përdorimin e elektroshtëpiakeve, përgatitjen e supës kremoze.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 16 - Me ndihmën e të rriturve të përgatitet një supë kremoze me perime.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 13

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Njohja nga rreziqet

Rezultatet e të nxënës të temës:

Përdor veglat shtëpiake (përzierës, shtrydhëse frutash, shporet elektrik), duke përgatitur prodhime të ndryshme ushqimore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: III.1, III.4, IV.7, V.9.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i mikserit, i blueses së frutave: Përgatitja e ëmbëlsirës pa pjekje

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Identifikon produktet ushqimore të shëndetshme;
- Përdor veglat shtëpiake gjatë gatimit;
- Përgatit ëmbëlsirë pa pjekje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, ilustrime, mikser, shtrydhëse frutash, tepsi, fruta, biskota, gjalpë etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënës

Bashkëbisedim

Parashitohet pyetja për diskutim: *Cilat produkte ushqimore përdorni më shumë në shtëpi? Cilat nga ato janë më të shëndetshme? Pse frutat bëjnë pjesë në ushqimet e shëndetshme?* etj.

Shpjegojmë që pasi ushqimi është burim kryesor i shëndetit të njeriut, atëherë duhet të jemi sa më të kujdesshëm që të konsumojmë ushqime sa më të shëndetshme.

Ndonjëherë kemi nevojë edhe për ëmbëlsira, prandaj të mundohemi që edhe ato të përgatiten me produkte të shëndetshme.

Njohja me rreziqet

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Mikser;
- Bluese.

Fjalorthi:

Bluese - aparat për bluarje.
Maskarpone - djathë i butë.

* Përdorimi i mikserit, i blueses së frutave: përgatitja e ëmbëlsirës pa pjekje



Ushqimi është faktori kryesor për shëndetin e njeriut, prandaj është shumë e rëndësishme që ne të konsumojmë ushqime të shëndetshme. Këto zakonisht na shërbejnë nga familjarët tanë më të rritur. Dalëngadalë, ne duhet të mësojmë të përgatisim vetë, në mungesë të tyre.

Përpos supës, ndonjëherë kemi nevojë edhe për ëmbëlsirë. Për përgatitjen e saj na nevojiten vegla të ndryshme, si: mikseri, shtrydhësja e frutave, bluesja etj. Do pasur parasysh këshillat për kujdes para, gjatë dhe pas përdorimit të këtyre pajisjeve elektrike.



Njohja me rreziqet

Recetë ëmbëlsire me fruta pa përkje:

300 g biskota - bluhet me bluese ose me dorë (vendosen biskotat në një qese, mbyllet dhe mbi të rëndojmë me hollues petashi);
 125 g gjalpë i shkrirë, kajmak i freskët ose ndonjë krem të ëmbël;
 500 g djathë i butë, bën edhe djathë maskarponë - përzihet me mikser derisa të bëhet krem dhe ndahet në dy pjesë, njëra pjesë përzihet me krem çokollate për dekorim në formë të tophave të vegjël;
 50 g sheqer pluhur;
 250 g krem çokollate;
 500 g banane ose frutë tjetër sipas dëshirës.

Përgatitja e ëmbëlsirës:

Së pari, biskotat e bluara përzihen me gjalpën e shkrirë dhe vendosen në enë që ka hapës anash. I rrafshojmë dhe i shtypim mirë në tepsi, pastaj enën e vendosim në frigorifer me ngrirje të thellë derisa të përgatitet mbushja.

Përgatitja e mbushjes:

500 g djathë të butë e përziejmë me mikser, i shtojmë kajmak, nëse është i freskët. Po ashtu i hedhim 50 g sheqer pluhur, por, nëse i shtojmë krem për ëmbëlsirë, nuk kemi nevojë. Pastaj e përziejmë derisa të bëhet krem e tëra. Masa ndahet në dy pjesë, mundësisht të barabarta.

Në shtresën e parë vendosim 500 g banane. I blujmë në shtrydhëse frutash dhe ia shtojmë gjysmës së ndarë të pjesës kremeze të mbushjes. Këtë përgatitje e shtrijmë mbi bazën e përgatitur me biskota dhe prapë e vendosim në frigorifer me ngrirje të thellë derisa të përgatitim kremin e dytë.

Kremit të shtresës së dytë, të ndarë më herët, i shtojmë 250 g krem çokollate. E përziejmë derisa të fitohet masa e njëtrajtshme, më pas e përhapim në tepsi, ku njëkohësisht edhe rendisim çokollatën në formë të tophave për dekorim, në mënyrë që të ngjiten në shtresën e rënduar më parë. Ëmbëlsirën e vendosim në frigorifer dhe e lëmë për 12 orë. Para se ta shërbejmë, e hapim pjesën anësore të tepsisë.

Këshillë:

Përgatitjen e ëmbëlsirës dhe të gatesave të tjera për herë të parë, bëjini së bashku me një të rritur.



28



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
 Përpunimi i përmbajtjes
 Punë e drejtuar**

Fillimisht kontrollohen përbërësit bazuar në recetën e ëmbëlsirës.



Përgatitja e ëmbëlsirës bëhet hap pas hapi me përdorim të kujdesshëm të veglave elektrike.

Para përdorimit të çfarëdo pajisjeje elektrike, sigurohemi që ta kontrollojmë kabllon pa e vënë në rrymë elektrike, të jemi të sigurt në mësimin e përdorimit të tyre se si funksionojnë, t'i mbyllim mirë para përdorimit etj.



**Përforcimi:
 Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
 Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Pasi të ketë përfunduar përgatitja e ëmbëlsirës, nxënësit punojnë në grupe faqen 18 në fletoren e punës. Secili grup do të diskutojë për vështirësitë e përgatitjes së ëmbëlsirës, çfarë përjetuan etj.

	Çfarë përjetuam? Vështirësitë në marrëdhënie.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e produkteve të shëndosha, përdorimin e kujdesshëm të veglave elektrike dhe përgatitjes së ëmbëlsirës.

Detyrë:

Shkruaj recetën e ëmbëlsirës që të pëlqen më shumë. Përpiqu ta gatuash me ndihmën e të rriturve në shtëpi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Njohja nga rreziqet

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Përdor pajisjet shtëpiake në mënyrë të drejtë dhe mbrohet nga rreziqet gjatë përdorimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.3; V.8; VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2; 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Përdorimi i drejtë i pajisjeve shtëpiake

- Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**
- Përshkruan vetitë e pajisjeve elektrike;
 - Dallon pajisjet elektrike nga njëra-tjetra;
 - Klasifikon funksionet e çdonjëres pajisje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

 **Parashikimi:**
Përgatitja për të nxënësve
Stuhi mendimesh

Paraqiten në videoprojektor disa pajisje elektrike, si: shporet elektrik, frigorifer, lavatriçe. Nxënësve u parashtrihen pyetjet:

- Çfarë shihni në projektor? (Pajisje elektrike)
- Si quhen mjetet elektrike që po shihni? (Shporet...)

Të gjitha përgjigjet e nxënësve shkruhen në rrathët bosh.



Mos harro!

Pajisjet elektrike që përdorim në shtëpi na mundësojnë një mënyrë jetese më të lehtë; për shembull, përgatitje më të shpejtë të ushqimeve në këtë rast. Por, ne çdoherë duhet të tregohemi të kujdesshëm: të bëjmë kontrollimin e tyre para përdorimit, duke filluar nga kabli i lidhjes në rreziqin elektrik.



Pyetje:

- Cila është detyra juaj e parë para se të filloni të përdorni ndonjë vegël elektrike?
- Nëse kabli i shtrydhëses së frutave është i zhveshur, a duhet ta përdorim? Çfarë rreziku sjell kjo?

*** Përdorimi i drejtë i pajisjeve shtëpiake**

Shumica e pajisjeve shtëpiake (ose të anvisërës) punojnë me rrymë elektrike, por ka edhe disa sosh që punojnë me gaz, siç janë shporet për zierje dhe pjekje, për ngrohje, llamba për ndriçim etj. Para se t'i përdorim ato, duhet të dimë cilat janë rregullat e përdorimit dhe rreziqet e mundshme.

Shporet me gaz është pajisje që punon me gaz dhe përdoret për pjekje dhe zierje. Këto pajisje nuk bën ta kyçim para se të jemi afër dhe ta ndezim me shkrepëse, sepse përbën rrezik që të shkaktohet zjarri. Po ashtu, edhe kur duam ta largojmë enën nga shporet me gaz duhet të tregohemi të kujdesshëm, sepse nëse e kapim direkt me dorë mund të na shkaktojë djegie.

Frigoriferi është pajisje me ftohje dhe ngriçje, që shërben për ruajtjen e ushqimeve. Ai na mundëson që qëndrojmë të freskët në tërë gjatë ditës dhe jo vetëm gjatë natës nga temperaturat e stinës së verës ose të ngrohjes shtëpiake gjatë stinës së dimrit.

Pra, na mundëson që gjërat ushqimore t'i mbajmë të freskëta dhe të ngriçura. Andaj, duhet kujdes i veçantë që të mos e harrojmë derën hapur, sepse rritet temperatura. Duhet të kemi kujdes që kabllin të mos e ndrydhim.



Njohja me rreziqet

Pjesa për ngrirje është e vendosur në pjesën e lartë ose në pjesën e poshtme. Andaj gjatë pastrimit të pjesës së ngrirjes, duhet kujdes i posaçëm që të mos e gërryjmë, por ta lëmë të shkrirët vetvetiu, sepse mund të çojë në prishje të frigoriferit.

Lavatriça është pajisje që punon me rrymë elektrike; mundëson larjen dhe dezinfektimin e rrobave. Ajo punon në temperatura nga 0 gradë celsius deri në 95 gradë celsius. Me temperatura të ulëta zakonisht lahen rrobat prej materialeve të ndjeshme, ngjyrat e llojllojshme, me qëllim të ruajtjes së tyre. Ndërsa në 95 gradë celsius lahen rrobat e bardha dhe të pambukta, sepse në këtë temperaturë bëhet zierja.

Së pari, i klasifikojmë rrobat që duhen larë; i vendosim në lavatriçe; e mbyllim derën; e vendosim detergjentin për larje dhe dezinfektim, dhe e shtypim butonin në temperaturën në të cilën duam t'i lajmë rrobat. Sa më e lartë të jetë temperatura, aq më shumë energji elektrike do të shpenzohet. Duhet të tregohemi të kujdesshëm gjatë kësaj në rrejet elektrik, si dhe të sigurohemi se ka ujë. Pa ujë, lavatriça nuk punon. Kjo, madje, mund ta dëmtojë atë.



Mos harro!

- Lavatriça, frigoriferi, shporet i shumë pajisje shtëpiake funksionojnë me energji elektrike dhe atë e shndërrojnë në temperaturë të lartë ose të ulët, andaj duhet të jemi të kujdesshëm dhe të parandalojmë rreziqet e mundshme.
- Në mungesë të ujit, asnjëherë mos e vër në funksion lavatriçen!
- Shporetin me gaz mos e ndiz në çelës asnjëherë, nëse nuk je i gatshëm ta përdorësh menjëherë dhe të qëndrosh aty afër.



Pyetje:

- Si funksionojnë lavatriça, frigoriferi dhe pajisje të tjera që përdorni në shtëpi?
- Për çfarë na shërben frigoriferi dhe çfarë temperature liron?
- Pse duhet të jemi të kujdesshëm gjatë përgatitjes së ushqimit në shporet me gaz?

30



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Punë e drejtuar

Shkruhet titulli i njësisë mësimore në tabelë. Pasi prezantohet njësia mësimore, nxënësve u drejtohen pyetjet:

- A mendoni se do të funksionojë shporet i elektrik në mungesë të rrymës?(Jo nuk funksionon)
- A guxojmë ta kyçim shporetin me gaz para se të jemi afër për ta ndezur me shkrepëse?(Jo)
- Me çfarë temperature punon lavatriça?(0-35 gradë celsius)
- Për çfarë na shërben frigoriferi?(Për ruajtjen e freskët të ushqimeve)



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Punë në grupe

Ndahen nxënësit në tri grupe. Secilit grup i caktohet detyra përkatëse, pra të gjejnë të mirat dhe rreziqet e secilit mjet elektrik nga këto që i mësuam.

Grupi i parë	Shporet elektrik
Grupi i dytë	Frigoriferi
Grupi i tretë	Lavatriça

Të gjitha grupet prezantojnë punën e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përgjigjet e sakta gjatë orës, për dallimin e pajisjeve, klasifikimin e funksioneve, për prezantimin e tyre.

Detyrë:

Formo një pesëvargësh me fjalën pajisje elektrike.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Njohja nga rreziqet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përdor pajisjet shtëpiake në mënyrë të drejtë dhe mbrohet nga rreziqet gjatë përdorimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.3; V.8; VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2; 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i drejtë i pajisjeve shtëpiake - Përforcim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon rreziqet nga energjia elektrike;
- Përshkruan rregullat e përdorimit të pajisjeve elektrike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, ilustrime, flipchart, fletë A4 .

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Pema e mendimeve

Shënohet në tabelë titulli “Pajisjet shtëpiake”, drejtohen pyetje me qëllim të rikujtimit të njohurive të marra. Plotësohet pema e mendimeve.

Ja disa pyetje:




1. Si funksionon lavatriçja? 2. Çfarë ndodh nëse e kyçim lavatriçen në mungesë uji?
3. Cilat janë pasojat kur kyçim shporetin me gaz para se të jemi afër për ta ndezur me shkrepëse?

Njohja me rreziqet

*** Si t'i përdorim pajisjet shtëpiake?**

Pasi aparatet dhe pajisjet shtëpiake i vë në funksion ose në punë energjia elektrike ose gazit, e dimë që ekzistojnë rreziqe të ndryshme, andaj duhet të kemi shumë kujdes gjatë përdorimit të tyre që t'i shmangim ato.

I. Të shkruajmë në tabelën më poshtë: si funksionojnë, si kryhet veprimi dhe cilat janë rreziqet e mundshme?


Pajisjet	Çfarë i vë në funksion?	Rreziqet e mundshme gjatë përdorimit:
		
		
		

● Njohja me rreziqet
* Fjalëkryqi



- Vertikalisht:**
- Shtrydhësja
 - Mikseri
- Horizontalisht:**
- Shporet
 - Frigoriferi
 - Lavatrica

20




**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**
Tabela e koncepteve

Pasi aparatet dhe pajisjet shtëpiake i vë në funksion ose në punë energjia elektrike ose gazi, duhet të kemi shumë kujdes gjatë përdorimit të tyre. Nxënësit në libër plotësojnë individualisht, shkruajnë se me çfarë funksionojnë pajisjet, si kryhet veprimi dhe për rreziqet e mundshme. Disa nxënës lexojnë përgjigjet.

	Çfarë i vë në funksion?	Rreziqet e mundshme gjatë përdorimit
		Në mungesë të ujit, mos e vër në funksion lavatricën.
	Energjia elektrike	

**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**
Organizues grafik i analogjisë - Fjalëkryqi

Shpjegohet mënyra e plotësimit të fjalëkryqit. Më pas vazhdohet të punohet në mënyrë individuale. Pasi të plotësohet fjalëkryqi, disa nxënës lexojnë punimet e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin e rreziqeve nga energjia elektrike dhe zbatimin e rregullave të përdorimit të drejtë të pajisjeve shtëpiake.

Detyrë:

Listo disa nga rregullat e përdorimit të pajisjeve elektrike. Arsyeto ato rregulla.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Karriera ime

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Paraqet video/foto me mënyrën e punës së profesioneve të ndryshme; Identifikon disa shkathësi dhe aftësi për profesionet e ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.2; III.2; VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 3.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çfarë dimë për profesionet?

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon çfarë janë profesionet;
 - Emërton profesione të familjarëve;
 - Identifikon profesione nga fotografia;
 - Luan lojë me role për profesionin që ai/ajo dëshiron.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, laps, fletore.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Organanizues grafik

Në njërën anë të tabelës ekspozohen disa fotografi me profesione të ndryshme, ndërsa në anën tjetër vendosen tiketat me emra profesionesh. Vështrohet tabela për pak minuta dhe përmes pyetjeve që parashtrohen nga mësuesja/i, nxënësit gjejnë emrin e profesionit që përshatet me fotografinë përkatëse. P.sh.
 - Çfarë shihni në këto fotografi? (Profesione të ndryshme si mjek...)
 - Cilat mjete janë adekuate për profesionin e mjekut? (Stetoskopi, matësi i tensionit...)



Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Profesionet;
- Karriera.

Fjalorthi:

Profesionist - person që është aftësuar për të kryer punë të caktuara me përgjegjësi profesionale.
Programi kompjuterik - një seri komandash që kryejnë veprime të pavarura në kompjuter.
Dosje - mbajtëse e thjeshtë dokumentesh, zakonisht me dy kapakë kartoni të lidhur bashkë; tërësia e dokumenteve që vihen brenda saj.

Karriera ime

*** Çfarë dimë për profesionet?**

Të rriturit kanë mësuar dhe janë aftësuar për të kryer punë të caktuara. Ne i njohim si profesionistë në punët e tyre. Edhe ju, sikurse ata, një ditë do t'i kenë profesionet tuaja.

Deri më tani kemi mësuar për profesione të ndryshme, si p.sh. për punën e artistit/es, mjekut/es, bujkut/eshës, flokëtarit/es, laborantit/es, këngëtarit/es, veterinerit/es etj. Jemi njohur edhe me vendet e punës së tyre nga fotot e treguara në libër dhe shpjegimet për to. Disa prej tyre edhe i kenë vizituar dhe njohur për së afërmi, si p.sh.: mjekun, flokëtarin, bujkun etj.

Përpos këtyre profesioneve, ka edhe shumë profesione të tjera, disa prej të cilave do t'i njohim në vijim.

*** Mësojmë më shumë për punët e të rriturve**

Më poshtë janë dhënë përshkrime të disa punëve që kryhen nga profesionistë të caktuar.

Puna me kompjuter sot është mjaft praktike dhe e shpeshtë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Punë në grupe

Në videoprojektor, paraqitet njëسيا mësimore. Diskutohet rreth njësisë dhe më pas paraqiten tri pyetjet e përgatitura paraprakisht për nxënësit e ndarë në grupe, si:

- Sa profesione i lexuam në tekst?
- A ka profesione të tjera që i di ti veç këtyre të paraqitura në videoprojektor?
- Përshkruaj punën që bën mësimdhënësi dhe përmend disa nga mjetet që përdor.

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rishikim në dyshe

Secilit nxënësi i caktohet një rol/profesion. Kërkohej nga ata që dalin në skenë e të luajnë rolin sipas imagjinatës së tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në orë, për përgjigjet e sakta dhe për lojën e mirë skenike.

Detyrë:

Gjej materiale dhe mjete pune të profesionit që të pëlqen të ushtrosh kur të rritesh. Nëse ka mundësi, silli ato për orën e ardhshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Karriera ime

Rezultatet e të nxënës të temës:
 Identifikon llojet e aktiviteteve në shkollë, shtëpi, komunitet dhe tregon lidhjen e tyre me profesionet e ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1; 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mësojmë më shumë për punët e të rriturve

- Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:**
- Dallon mjetet e punës për një profesion të caktuar.
 - Përshkruan profesione të ndryshme.
 - Vizaton në fletën A4 vegla të ndryshme sipas profesioneve që i kanë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, laptopi, kalkulatori.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënës
Përmbledhje e strukturuar e mjeteve të punës

Nxënësit janë porositur që të sjellin në klasë mjete për profesione të ndryshme, si: laptop, kalkulator për llogaritje (financa), makinë shkrimi (nese ka ndokush në shtëpi).
 Vendosen mbi banka mjetet e sjella dhe i klasifikojnë ato për tri profesionet për të cilat do të flasim në vazhdim.
 Orientohen nxënësit për veprimtarinë që do të realizojnë.




Karriera ime

Programimi nënkupton t'i japim kompjuterit udhëzime si të kryejë punë dhe funksione të ndryshme. Në ditët e sotme, ky profesion është i domosdoshëm dhe ka të ardhme të mirë, andaj edhe është mjaft tërheqës për shumë të rinj.



Në këtë fotografi shohim dikë që po bën llogaritjen e pagave, llogaritjet e shitjeve, blerjeve dhe punëve të tjera me para.

Ju tashmë keni lexuar libra të ndryshëm, qoftë enciklopedi, lektura shkollore, romane, libra me poezi etj. Edhe shkrimi i librave është një profesion.



Në bazë të informacioneve të dhëna më sipër, bisedoni në grupe dhe tregoni se si quhen personat që i kryejnë profesionet e përshkruara.

32



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Pyetja sjell pyetjen*

Lexohet teksti me pjesë-pjesë dhe, pas çdo pjesë të lexuar, parashtrohen pyetje për diskutim.

Programuesja/i

- Çka është programi kompjuterik? (Tërësi e veprimeve që duhet t'i kryejë kompjuteri)
- Çfarë programesh ka kompjuteri? (Për mësim, lojëra të ndryshme, mjekësi, inxhinieri)

Financierja/i

- Me cilat vegla ka punuar financierja/i në të kaluarën? (Laps dhe kalkulator)
- Cili është sot mjeti kryesor për të bërë punë të suksesshme? (Kompjuteri)

Shkrimtarja/i

- Cilët janë ata që shkruajnë libra dhe si quhen? (Shkrimtarë)
- Çfarë kuptojmë dhe mësojmë gjatë leximit? (Nga jeta e të tjerëve)



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit *Loja me role*

Shpërndahen fletët A4, ku në to janë të vizatuara elemente identifikuese për profesione të ndryshme.

Udhëzohen nxënësit që konform profesionistit/es, të vizatojnë në fletë mjetet adekuate.

Diskutojnë në dyshe për rëndësinë e çdonjërës nga mjetet e punës dhe më pas prezantojnë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin e mjeteve të punës për profesione të ndryshme, për saktësinë e vizatimit të tyre.

Detyrë:

Tregimin e imagjinuar shkruaje me kompjuter.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Karriera ime

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Identifikon disa shkathhtësi dhe aftësi për profesionet e ndryshme;
 Identifikon llojet e aktiviteteve në shkollë, shtëpi, komunitet dhe tregon lidhjen e tyre me profesionet e ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.2; III.1, III.2; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mësojmë më shumë për punën e të rriturve - Përsëritje

- Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**
- Hulumton në internet për t'u informuar më detajisht për financat;
 - Përdor kompjuterin për të bërë llogaritje të ndryshme;
 - Shkruan me laptop, një tekst të imagjinuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuter, kalkulator, letër A4, laps.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësve
 Përmbledhje e strukturuar

Orientohen nxënësit për veprimtarinë që do të realizojnë. Të realizohen me laptop projekte të ndryshme, financat familjare (pagat, shitjet, blerjet...) dhe shkrimin e një tregimi të imagjinuar.




* Financieri/ja



Punët që bëjnë profesionistët dhe të tjerët gjithmonë përcillen me blerje, shitje dhe pagesa të ndryshme me para. Financierja do të bëjë llogaritjet për të gjitha dhe do t'i ruajë ato në dosjet e veta.

Me cilat vegla ka punuar financierja në të kaluarën? Çfarë përdor sot për të kryer punën e vet?
Dikur ka punuar me laps dhe kalkulator.

Sot, kompjuteri sërisht është mjeti kryesor për të bërë punë të suksesshme. Por, ai duhet të ketë programin, i cili i mundëson t'i kryejë punët me saktësi dhe shpejtësi. Lapsi dhe kalkulatori përdoren në raste shumë të rralla.



Dikur



Sot

35



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Leksion i përparuar

Nxënësit ndahen në tri grupe me numër çift. Udhëzohen anëtarët e grupit të caktuar për detyrën që do të punojnë. Së pari hidhen idetë në letër A4. Pas disa minutash, udhëzohen dyshet që t'u tregojnë edhe të tjerëve brenda grupit për atë që kanë shkruar. Kërkohej dhënia e ideve para klasës, duke shkruar në tabelë disa nga mendimet e nxënësve. Kështu u lehtësohet puna të gjitha grupeve për të vazhduar me detyrën e caktuar.

Grupi i parë	Financat
Grupi i dytë	Projektimi
Grupi i tretë	Shkrimi i tekstit



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxëniet Prezantohen detyrat para klasës



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për bashkëpunimin në grup, për informatat e sakta rreth financave, për llogaritjet të ndryshme me anë të kalkulatorit, si dhe për shkruarjen e tekstit me laptop.

Detyrë:

Puno financat mujore të familjes (shitjet, blerjet, pagat...).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Karriera ime

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Sheh punën (në institucione, punëtori, fabrika etj.) e disa profesioneve të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2, III.3; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2; 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Një vizitë në biznese

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon karakteristikat themelore të funksionimit të fabrikës;
 - Emërton disa nga profesionet e punëtorëve të fabrikës;
 - Shpjegon përshtypjet e vizitës në fabrikën e prodhimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletore, laps.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë

Në fillim të vitit shkollor është bërë plani i aktiviteteve, në mesin e tyre edhe i vizitave jashtëkurrikulare, ku është paraparë që më datë dhe muaj të caktuar të bëhet vizitë në fabrikën e prodhimeve (ushqim, veshje etj.) Aty takohen punëtorë me profesione të ndryshme. Intervistohen disa prej tyre.

Karriera ime
*** Shkrimtari/ja**



Kemi lexuar shumë libra, nga të cilët kemi mësuar shumë gjëra interesante. Prej tyre kemi mësuar për të kaluarën e njerëzve, ngjarjet që kanë ndodhur; kemi mësuar për botën, për kulturat e ndryshme etj.

A keni menduar se kush janë ata që i kanë shkruar këta libra dhe si quhet profesioni i tyre?

Ata janë shkrimtarët. Shkrimtarët shkruajnë për ngjarje të ndryshme. Gjatë leximit kuptojmë dhe mësojmë shumë nga jeta e të tjerëve.




Shumë kohë më parë shkrimtarët kanë shkruar me pendë.



Më vonë e përdorën lapsin.



Kohë më parë e kanë përdorur edhe makinën e shkrimit.



Sot, edhe për shkrimtarin, mjeti kryesor është kompjuteri.

Çfarë mund të bëjmë për të mësuar më shumë? Me ndihmën e mësimitdhënësi/es formohen grupet e nxënësve për organizimin e vizitave në vende të ndryshme të punës, sipas mundësive, për të përfituar njohuri praktike për ato profesione.

*** Një vizitë në biznese**

Ju mund të vizitoni një biznes dhe aty do të takoni shumë profesionistë të punës me kompjuter.



Vizita në kompani me profesionistë të TIK-ut.

Karriera ime

- Proveni të vizitoni edhe ndonjë fabrikë të prodhimeve (ushqimeve, veshjeve etj.). Aty do të takoni edhe punëtorin e financave (financierin/en), por edhe profesionistë të tjerë.



Vizita në një fabrikë ushqimi.


Pas çdo vizite, bisedoni për përshtypjet tuaja dhe njohuritë e reja që i keni marrë.

* Mësojmë programimin në kompjuter

Programimi në kompjuter jua mundëson të bëni gjëra shumë interesante. Një program ku mund të provoni dhe të mësoni çfarë mund të bëni me programim quhet **Scratch**. Ky program është përgatitur të jetë i thjeshtë dhe praktik (i lehtë për t'u përdorur). Urdhrat janë zëvendësuar me blloqe, të cilat janë më të kuptueshme për fëmijët.

Në shkollën tuaj kërkonti të keni këtë program në kompjuter.

Ja si duket hapësira ku kryhet programimi në kompjuter dhe ku është programuar një melodi me saksofon:



Nëse shtypet mbi flamurin e gjelbër, do të dëgjohet një melodi me instrumentin e zgjedhur.

Do të mund ta bëni edhe ju vetë, pasi mësuesi/ja ta përgatisë programin në kompjuter, i cili merret falas në internet.

Si mund të bëhet kjo?

37



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Vizita në fabrikë

Realizohet me sukses vizita, nxënësit shohin për së afërmi se si zhvillohet biznesi dhe punët që bëjnë profesionistë të ndryshëm.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Kthehemi në klasë dhe nxënësit udhëzohen të shkruajnë ese me temën: “Vizita në fabrikën e prodhimeve”.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pyetjet me kuptim, të bëra punëtorëve të fabrikës, vlerësohen me fjalë dhe shprehje për sjelljen e mirë gjatë vizitës.

Detyrë:

Vizato fabrikën e vizituar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Karriera ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Krijon modele ose vizatime të thjeshta me anë të programit kompjuterik.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I.3; III.2, III.3; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 4.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mësojmë programimin në kompjuter

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon pjesët kryesore të kompjuterit;
- Hulumton në internet për t'u informuar më detajisht për programe të ndryshme dhe krijon një melodi me kitarë;
- Zbaton rregullat e qëndrimit dhe të përdorimit të kompjuterit dhe internetit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, fletë A4, laps.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Organizues grafik i analogjisë

Pasi orën paraprake nxënësit janë udhëzuar të shkruajnë ese rreth vizitës së bërë fabrikës së prodhimit, atëherë ata lexojnë esetë e tyre. U parashtrohet pyetja: Esetë i keni shkruar me dorë apo me kompjuter? Merren përgjigjet e nxënësve.

Ngjashmëritë

Dallimet

Karriera ime
 Proveni të vizitoni edhe ndonjë fabrikë të prodhimeve (ushqimeve, veshjeve etj.). Aty do të takoni edhe punëtorin e financave (financierin/en), por edhe profesionistë të tjerë.



Vizita në një fabrikë ushqimi.


Pas çdo vizite, bisedoni për përshypjet tuaja dhe njohuritë e reja që i keni marrë.

Mësojmë programimin në kompjuter

Programimi në kompjuter jua mundëson të bëni gjëra shumë interesante. Një program ku mund të provoni dhe të mësoni çfarë mund të bëni me programim quhet **Scratch**. Ky program është përgatitur të jetë i thjeshtë dhe praktik (i lehtë për t'u përdorur). Urdhrat janë zëvendësuar me blloqe, të cilat janë më të kuptueshme për fëmijët.

Në shkollën tuaj kërkoni të keni këtë program në kompjuter.

Ja si duket hapësira ku kryhet programimi në kompjuter dhe ku është programuar një melodi me saksofon:



Nëse shtypet mbi flamurin e gjelbër, do të dëgjohet një melodi me instrumentin e zgjedhur.

Do të mund ta bëni edhe ju vetë, pasi mësuesi/jja ta përgatisë programin në kompjuter, i cili merret falas në internet.

Si mund të bëhet kjo?

Karriera ime

Pasi të hapet programi, nga ana e majtë e dritares, merri pjesët që formojnë programin si në figurën e sipërme.



Renditni pjesët si në program dhe, te vegla në vend të numrit 1, shkruani O.I. Shtypni me miun mbi flakur dhe do të ekzekutohet melodia me saksofon.

Programi ka shumë mundësi, por këta janë hapat e parë për programim. Me ndihmën e mësuesit/es, provoni edhe mundësi të tjera.



38



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Veprimtari e mendimit të drejtuar

Hapet libri faqe 37-38 dhe diskutohet rreth përmbajtjes së tekstit. Mes të tjerash, fokusi përqëndrohet te programi i quajtur Scratch. Program ky që është i përgatitur të jetë i thjeshtë dhe praktik për nxënës.

Provohet të preken, të emërtohen dhe të kuptohet funksioni i secilës pjesë të kompjuterit. Praktikohet edhe programi Scratch, ku përmes eksplorimit hasen lojëra, filma, muzikë.

Atëherë, me udhëzimet e mjaftueshme, me maus zgjidhet kitarra elektrike dhe, duke shtypur mbi figurën e kitarës ajo paraqitet në program. Me anë të blloqeve merret melodia e re me kitarë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët

Kokat e numëruara

Brenda grupit, nxënësit numërohen prej 3 ose 4 nxënës. Jepen udhëzimet dhe detajet rreth detyrës. Mendohet për detyrën në mënyrën individuale dhe pas pak e diskutojnë detyrën në grup, e zbatohet.

Atëherë me ndihmën e mësueses/it aty ku ka nevojë. Ftohen për prezantim të gjithë nxënësit apo vetëm disa prej tyre (varësisht nga koha).



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për prezantimin e detyrës së shtëpisë, praktikimin me sukses të programit Scratch dhe për krijimin e melodisë së re me kitarë.

Detyrë:

Krijo një melodi të re me kitarën elektrike, duke praktikuar programin Scratch.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 21

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Planifikon aktivitete të ekonomisë familjare.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mësojmë të vizatojmë me kompjuter

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Praktikon pa problem programin Paint;
 - Vizaton kompjuterin dhe pjesët e tij.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.



Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, tabelë, fletë A4, laps, fletore, shkumës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Edukatë figurative, Gjuhë shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Pema e mendimit

Në tabelë vizatohet pema e mendimit. Shkruhen emrat e pjesëve të kompjuterit, kërkohet nga nxënësit të tregojnë rolin dhe rëndësinë e çdonjërës nga to. Përgjigjet e tyre shkruhen në degëzimet pranë emrave adekuatë. Ja një shembull:



Planifikimi


3

Në hapësirën e bardhë, vizatoni dhe ngjyrosni sipas dëshirës dhe ideve që keni. Në figurën vijuese është vizatuar dhe ngjyrosur një kompjuter.



* Si të vizatojmë me programin Paint?

Vizatimi me Paint është sikur ai me letër, laps dhe ngjyra. Shfrytëzimi i këtij programi bëhet me ndihmën e miut, sepse pa të lëvizja e treguesit (kursorit) në ekran dhe vendosja e tij në vendin e dëshiruar është më e vështirë. Për të përdorur me lehtësi programin **Paint**, është e nevojshme që të kuptojmë se për çfarë nevojitet secila vegël. Ato, zakonisht, vendosen në pjesën e sipërme të dritares dhe kombinohen me ngjyra përkatëse. Gjatë vizatimit me programin **Paint**, duhet të kemi ide se çka do të vizatojmë.



Në vazhdim, do të shpjegojmë se si mund t'i përdorim disa prej veglave më të rëndësishme:



- Është vegla e lapsit dhe me të mund të vizatojmë vija me trashësi dhe ngjyra të ndryshme.

Trashësinë dhe ngjyrën i zgjedhim nga dy figurat e mëposhtme. Së pari e zgjedhim lapsin, pastaj trashësinë dhe ngjyrën e vijës (me veglën **Color 1** dhe ngjyrën e caktuar).



40



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Punë e drejtuar

Hapet libri faqe 39-40. Lexohet dhe shpjegohet teksti i dhënë, ndihmuar edhe nga figurat përkatëse.

Parashtrihen pyetjet, si:

- Cili qenka programi për vizatim? (Paint)
- Pjesë përbërëse e kujt është programi Paint? (*E Windows-it*)



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Punë e pavarur

Në mënyrë të pavarur nxënësit provojnë të vizatojnë objekte apo figura të ndryshme me kompjuter përmes programit Paint.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin e rolit të pjesëve të kompjuterit, për përgjigjet e sakta dhe për punën e pavarur.

Detyrë:

Me programin Paint, puno një vizatim sipas dëshirës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Krijon modele ose vizatime të thjeshta me anë të programit kompjuterik.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si të vizatojmë me programin *Paint*?

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përdor saktë veglat e programit Paint;
 - Vizaton me lehtësi figura të ndryshme;
 - Zbaton hapat e mënyrës së ruajtjes së vizatimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.



Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Edukatë figurative, Gjuhë shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS


Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Meqenëse nxënësit detyrë për në shtëpi kanë pasur vizatimin e dhomës së tyre. Pyeten se si e kanë realizuar këtë vizatim. Së bashku me ta përshkruhen hapat e realizimit të detyrës. Kërkohet edhe në mënyrë praktike ta demonstrojnë vizatimin e bërë.



Planifikimi

Paraqet gomën, përmes së cilës mund të fshijmë cilëndo pjesë të vizatimit. Për këtë i zgjedhim gomën dhe ngjyrën e bardhë nga **Color 2**.



Shikoni si mund të duket një pikturë në Paint. Provoni ta bëni edhe ju!



42



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Përmbledhja pohim-mbështetje*


Hapet teksti dhe analizohet mënyra e përdorimit të programit Paint. Merren udhëzimet se si të përdoren disa nga veglat më të rëndësishme dhe me to të vizatohet dhe të ruhet vizatimi.

Në projektor paraqitet shembulli i një vizatimi të një pikturë dhe mënyra e ruajtjes së saj.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit *Imagjinata e drejtuar*

Me anë të laptopit, punohet nga nxënësit një figurë e imagjinuar, duke i zbatuar me përpikëri udhëzimet e marra nga njësia mësimore dhe nga videoja e paraqitur në projektor.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përdorimin e saktë të veglave të programit Paint, për vizatimin me lehtësi të figurave dhe për zbatimin e hapave të sigurt për ruajtjen e vizatimit.

Detyrë:

Vizato një pikturë me programin Paint dhe ruaje atë në bazë të udhëzimeve të marra paraprakisht.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Përgatit një plan pune njëjavor, rendit dhe argumenton veprimet prioritare.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.3; III.3; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2; 5.1; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Planifikojmë obligimet e javës

- Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**
- Dallon veprimet kryesore gjatë javës;
 - Planifikon orarin javor, bazuar në veprime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, stilolaps, ilustrime, fisha me fjalë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Terma paraprakë

Në fishat që u shpërndahen nxënësve janë të shkruara termat paraprakë (fjalët), si: orar, mësim, planifikim, kohë. Termat diskutohen në dyshe dhe në grupe duke shkruar rrëfime personale. Tre ose katër nxënës lexojnë punimet e veta, të parashikuara dhe të asociuara.



Planifikimi

Të gjithë duhet të planifikojmë atë që do të bëjmë gjatë javës. Kështu veprimi edhe Arba, për mësimet e saj.

Ja si veprimi Arba, nxënësi e klasës së katërt:

Arba kishte filluar klasën e katërt dhe po mendonte - ajo dëshironte që të dilte e shkëlqyeshme në të gjitha lëndët. Në vitin e kaluar, nuk i kishte shkruar mbarë me mësimet. Kishte mësuar, por nuk kishte arritur suksesin e dëshiruar. Kishte mësuar sa herë që mësuesja kishte kërkuar që të përgatiteshin për test. Ishte angazhuar shumë, por ja që nuk ishte e kënaqur me suksesin. U mendua gjatë, por nuk dinte si të bënte një plan mësimi, që të ishte më e suksesshme.

Pasi mendoi gjatë, vendosi ta pyeste vëllanë e madh, Lumin.

- Vëlla, i kam kryer detyrat, jam përgatitur sa herë që kemi pasur test, por nuk kam arritur të jem e dalluar në mësimet. Çfarë mund të bëj? A mund të jem më e suksesshme apo të pajtohem se nuk mundem më tepër?!

Ai e dëgjoi me vëmendje dhe mendoi se si ta ndihmonte. Filloi t'i analizonte sjelljet e saj. Mendoi se çka mund të ndryshonte për të arritur atë që dëshironte. Pasi u mendua gjatë më në fund gjeti se motra e tij kishte mundësi të ndryshonte diçka. Ajo nuk kishte mësuar në mënyrë të vazhdueshme. Nuk i kishte mësuar mësimet e reja, pasi i kishte shpjeguar mësuesja, por vetëm kur duhej të përgatitej për teste. Kjo i kishte shkaktuar probleme, sepse i kishte marrë shumë kohë për t'i mësuar njësitë mësimore nga fillimi. I kishte haruar shpjegimet e mësueses dhe duhej t'i mësonte e vetme. Kjo i merrte shumë kohë dhe nuk arrinte të përgatitej aq sa për të arritur sukses. Lumi i shpjegoi Arbës se kishte mundësi që të përmirësohej, por duhej të bënin një plan për një javë. Të njëjtin duhej ta zbatonte për çdo javë.

Ja se çfarë planifikuan:

Të dytë u pajtuan që çdo ditë ajo duhej të mësonte. Pasi të kthehej nga shkolla duhej t'i përgatiste mësimet e reja që ishin shpjeguar në klasë. Në pjesën tjetër të kohës, do t'i kryente detyrat e shtëpisë. Në fund, do t'i përsëriste mësimet e kaluara, sipas orarit për ditën e nesërme. Kështu, ajo do të ishte e përgatitur për çdo ditë. Arba do të vazhonte sipas këtij planifikimi deri në përfundim të gjysmëvjetorit të parë. Njëjtë do të vepronte edhe në gjysmëvjetorin e dytë, që në fillim të tij.

Për ta pasur më të qartë atë që do të mësonin brenda ditës dhe javës, ata u pajtuan që ta bënin orarin e mësimave për tërë javën. Pasi mësimi fillonte në orën 08:00 të mëngjesit, ndërsa nga shkolla kthehej në orën 12:30, mësimet do të planifikoheshin pasdite.

Orari i mësimave në klasë ishte:

Planifikimi

Dita/ora mësimore	I	II	III	IV	V
E hënë	Gjuhë shqipe	Matematikë	Edukatë fizike	Njeriu dhe natyra	Edukatë muzikore
E martë	Shoqëria dhe mjedisi	Gjuhë angleze	Gjuhë shqipe	Matematikë	Edukatë fizike
E mërkurë	Gjuhë shqipe	Njeriu dhe natyra	Matematikë	Shkathësi për jetë	Edukatë figurative
E enjte	Gjuhë shqipe	Matematikë	Shoqëria dhe mjedisi	Shkathësi për jetë	Edukatë muzikore
E premte	Matematikë	Gjuhë shqipe	Gjuhë angleze	Edukatë figurative	

Sipas orarit, Arba dhe vëllai i saj e përgatitën planin e mësimin për tërë javën. Ata filluan me nga katër orë në ditë, por u pajtuan ta zgjasnin ose ta shkurtonin, pasi ta shihnin suksesin nga perioda e parë.

Plani javor i mësimin:

Dita/ora	15:00 - 16:00	16:00 - 17:00	18:00 - 19:00
E hënë	Përgatitja e mësiminve të reja nga Matematika, Gjuha shqipe dhe Njeriu dhe natyra.	Kryerja e detyrave të shtëpisë nga Matematika, Gjuha shqipe dhe Njeriu dhe natyra.	Përsëritje e mësiminve nga Matematika, Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, si dhe Gjuha angleze.
E martë	Përgatitja e mësiminve të reja nga Matematika, Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, si dhe Gjuha angleze.	Kryerja e detyrave të shtëpisë nga Matematika, Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, si dhe Gjuha angleze.	Përsëritje e mësiminve nga Matematika, Gjuha shqipe, Njeriu dhe natyra, si dhe Shkathësi për jetë.
E mërkurë	Përgatitja e mësiminve të reja nga Matematika, Gjuha shqipe, Njeriu dhe natyra, si dhe Shkathësi për jetë.	Kryerja e detyrave të shtëpisë nga Matematika, Gjuha shqipe, Njeriu dhe natyra, si dhe Shkathësi për jetë.	Përsëritje e mësiminve nga Matematika, Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, si dhe Gjuha angleze.

44



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shpjegim i përparuar**

Në tabelë ekspozohet ilustrimi i një modeli të planifikimit javor.

Dita/ora	16:00-18:00	18:00-19:00	19:00-02:00
E hënë			Pun. i det. të shtëp.
E martë			
E mërkurë		Përg.e mës. të reja	
E enjte			
E premte			

Njoftohen nxënësit me njësinë e re. Analizohet struktura e tekstit duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Ç'loj veprimtarie bëni në mëngjes? (Gjimmastikë)
- Cili është qëllimi i veprimtarisë që bëni? (Shëndeti i mirë)
- Kur i punoni detyrat e shtëpisë dhe kush ju ndihmon?
- Në ç'kohë bini të flini?

Në fletët A4, udhëzohen nxënësit të planifikojnë orarin javor bazuar në ilustrimin e ekspozuar në tabelë.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Stilolapsat në mes**

Pasi ta kenë përfunduar planifikimin javor, vendosin stilolapsat në mes të bankës. Tërheq një stilolaps duke pyetur se i kujt është. Nxënësi që deklarohet bën prezantimin e detyrës (punës). Vazhdon aktiviteti aq sa premtion koha.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin e veprimeve kryesore gjatë javës, planifikimin e orarit javor dhe përgjigjet e sakta.

Detyrë:

Planifiko një orar të mirëfilltë javor.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përgatit një plan javor pune, rendit dhe argumenton veprimet prioritare.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.3; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndihmojmë në kuzhinë

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Prezanton veprimtaritë e anëtarëve të familjes;
 - Përshkruan aktivitetet që bën gjatë ditës;
 - Zbaton rregullat e caktuara familjare.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Flipçart*, markera me ngjyra, tabelë, shkumës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Tabela e koncepteve

Eksponohet punimi në flipçart, në të cilin është ilustruar puna që bëjnë në shtëpi katër anëtarët e familjes. Poshtë ilustrimit është e vizatuar tabela me emra të anëtarëve të asaj familjeje. Plotësohet tabela me idetë dhe mendimet e nxënësve për aktivitetet që bën çdonjëri nga familjarët.



Së pari, unë dhe motra vendosëm që të mësojmë bashkë dhe t'i kryejmë detyrat pa ndihmën e prindërve.



Përveç që i kryem detyrat vetë, ne, me kënaqësi, filluam t'i ndihmojmë prindërit edhe për përgatitjen e ushqimit. Ata u gëzuan shumë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Prezantohet titulli i njësisë. Analizohet përmbajtja e tekstit. Drejtohen pyetjet:

- Çfarë pune po kryejnë fëmijët në ilustrim?
- Si ju duket, a kanë harmoni familjare?
- Cila është puna që po bën babai?
- Po nëna, çfarë po gatuan?



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rrjeti i diskutimit

Po

Jo

- A duhet fëmijët të bëjnë fëmijët punë shtëpie?

Nxënësit japin idetë e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për prezantimin e veprimtarive, për përshkrimin e aktiviteteve dhe për përgjigjet e sakta.

Detyrë:

Listo punët e çdonjërit nga anëtarët e familjes.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon domethënien e shenjave të rrezikut për mbeturina të caktuara;
 Argumenton shkallën e rrezikut për secilën mbeturinë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.1; IV.2; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Domethënia e shenjave të rrezikut në lidhje me mbeturinat e caktuara

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon mjetet për eliminimin e mbetjeve të rrezikshme;
 - Identifikon shenjat e rrezikut;
 - Tregon mënyrat e shmangies nga rreziku i tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë, shkumësa me ngjyra, fletore, laps.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Di - Dua të di - Mësova më tepër

Di	Dua të di	Mësova më tepër
Di që tensioni i lartë është i rrezikshëm.	-Si t'i shmangemi rrezikut?	Në vendin e deponimit të tyre, vendoset shenja rrezik.
-	-	-
-	-	-
-	-	-



Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Materialet toksike;
- Materialet radioaktive;
- Tensioni elektrik;
- Materialet biologjike.

Fjalorthi:

Substanca - materia, lënda.
Objekt i urgjencës - ndërtesë ku ofrohen shërbime të shpejta.
Sfond - prapavijë.
Bordurë - vijë e plotë kufizimi.

Mjedisi dhe shëndeti

* Domethënia e shenjave të rrezikut në lidhje me mbeturinat e caktuara

Mbeturinat zakonisht krijohen gjatë përpunimit të materialeve të ndryshme. Në jetën e përditshme, dallohen dy lloje mbeturinash: ato industriale dhe të punishteve. Mbeturinat mund të shkaktojnë dëme në shëndetin dhe jetën e njerëzve nëpërmjet krijimit të nxënësve të sëmundjeve. Era dhe pamja e mbeturinave ndikojnë jo vetëm në tokë, por edhe në ambient në përgjithësi, në ajër e ujë.

Disa prej mbeturinave janë shumë të rrezikshme, andaj në vendin e deponimit të tyre vendosen shenja që tregojnë rrezikshmërinë e tyre. Në depot dhe hapësirat ku vendosen materialet e rrezikshme duhet të vendosen shenjat: **Rrezik për materiale toksike, shpërthyes, të ndezshme, radioaktive etj.**

Më poshtë janë paraqitur disa prej këtyre shenjave:



Rrezik - materiale toksike (helmuese)



Rrezik - tensioni elektrik



Rrezik - materiale shpërthyes



Rrezik - fushë magnetike e lartë



Rrezik - materiale të ndezshme



Rrezik - materie biologjike



Rrezik - materiale radioaktive



Rrezik - rreze laseri

49

Në fillim të orës paraqitet tabela e INSERT-it, e punuar për tri etapat e orës, ku lart është shënuar titulli i njesisë.

Në shtyllën e parë shënohen opinionet e nxënësve. P.sh.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Dua të di – Në këtë rubrikë shënohen pyetjet për të cilat nxënësit janë kureshtarë të dinë më shumë rreth njesisë së re. Ja disa nga pyetjet e mundshme:

- Si krijohen mbeturinat? (Gjatë përpunimit të materialeve të ndryshme)
- Sa lloje mbeturinash dallohen në jetën e përditshme? (Dy lloje)
- Çfarë dëmsh mund të shkaktojnë mbeturinat në jetën dhe shëndetin e njeriut?
- Çka nënkuptojmë me shenjën rrezik i materialeve toksike?



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Mësua më tepër

Shtylla e tretë e tabelës së INSERT-it e ekspozuar plotësohet nga nxënësit, duke lexuar tekstin e dhënë në pyetjet e parashtruara, por edhe informimet e marra nga mësuesja/i.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për plotësimin e saktë të shtyllës së tretë të tabelës, për pyetjet e bëra me kuptim dhe për njohuritë paraprake rreth njesisë.

Detyrë:

Në Diagramin e Venit, puno të përbashkëtat dhe të veçantat e mbeturinave industriale dhe të atyre të punishteve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathhtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Argumenton shkallën e rrezikut për secilën mbeturinë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-3, II-8, III-1, V-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6:1, 9:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shkalla e rrezikut nga mbeturinat e caktuara

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Dallon shenjat e rrezikut për mbeturinat;
- Kategorizon rreziqet nga mbeturinat.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, internet dhe fotografi të ndryshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Organizues grafik i analogjisë

Kujtojmë njohuritë paraprake të nxënësve, duke plotësuar organizuesin grafik të përgatitur paraprakisht. Shkalla e rrezikut nga mbeturinat e caktuara varet nga lloji dhe sasia e tyre në mjediset e ndryshme. Andaj, në mjediset ku ka mbeturina të këtitlla, vendosen shenjat që tregojnë rrezikun nga to.

Ndalim	
Paralajmërim	
E detyrueshme	
Urgjente	

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Mjedisi dhe shëndeti



Pyetje:

- Çka nënkupton me shenjë rrezik - materiale shpërthyes?
- Çka nënkupton me shenjë rrezik - materiale toksike?

Shkalla e rrezikut nga mbeturinat e caktuara

Shkalla e rrezikut nga mbeturinat e caktuara varet nga lloji dhe sasia e tyre në mjediset e ndryshme. Andaj, në mjediset ku ka mbeturina të këtitlla, vendosen shenjat që tregojnë rrezikun nga to. Këto mbeturina mund të jenë mbeturina kimike, substancat që mund të shkaktojnë sëmundje të rrezikshme, si dhe mbetjet e spitaleve, të thertoreve etj. Prandaj, duhet pasur kujdes që këto mbeturina të mos hidhen me mbeturinat e tjera të përditshme.

Mbeturinat e tjera të rrezikshme janë ato radioaktive (mbeturinat atomike/bërthamore), që paraqesin një problem shumë të madh për shkak të shpërbërjes së ngadalshme. Këto mbeturina vijnë si pjesë e përpunimeve të ndryshme apo përdorimit të substancave radioaktive (sidomos në reaktorët bërthamorë).







Për të treguar shkallën e rrezikshmërisë, shenjat dhe simbolet e sigurisë hyjnë në një nga katër kategoritë:

- Ndalim;
- Paralajmërim;
- E detyrueshme;
- Urgjente.

Duke i njohur karakteristikat kryesore të secilit lloj të simbolit, do të jeni në gjendje të identifikoni lehtësisht, nëse një shenjë po ju kërkon të ndaloni të bëni diçka; të filloni të bëni diçka; të merrni masa paraprake ose t'ju këshillojë për pajisjet ose objektet e urgjencës. Ja disa nga këto shenja:

Kategoria	Simboli	Karakteristikat	Ngjyrat
Ndalim		Ndalim i ndezjes së flakës	Formë e rrumbullakët; Figura e zezë në sfond të bardhë; Bordurë e kuqe me një vijë të kuqe diagonale.
		Ndalim i hedhjes në flakë	
			E kuqe



Paralajmërim	 Paralajmërim i sipërfaqes së nxehtë  Paralajmërim i rrezatimit optik	Formë trekëndëshi; Figura e zezë në sfond të verdhë; Bordurë e zezë.	E verdhë
E detyrueshme	 E detyrueshme mbajtja e helmetës  E detyrueshme mbajtja e syzeve	Formë e rrumbullakët; Figura e bardhë në sfond të kaltër.	E kaltër
Urgjente	 Ndihma e parë  Shkallët	Formë drejtkëndëshe ose katrore; Figura e bardhë në sfond të gjelbër.	E gjelbër



Pyetje:

- Çka nënkupton me shenjën - rrezik i kategorisë ndalim?
- Çka nënkupton me shenjën - rrezik i kategorisë së detyrueshme?
- Çka nënkupton me shenjën - rrezik i kategorisë paralajmërim?
- Çka nënkupton me shenjën - rrezik i kategorisë urgjente?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Komentojmë dhe shenjojmë secilën shenjë.



Duke i njohur karakteristikat kryesore të secilit lloj të simbolit, do të jeni në gjendje të identifikoni lehtësisht, nëse një shenjë po ju kërkon të ndaloni të bëni diçka; të filloni të bëni diçka; të merrni masa paraprake ose t'ju këshillojë për pajisjet ose objektet e urgjencës.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Mbajtja e strukturuar e shënimeve**

Përsëritje e shenjave sipas formës dhe figurave, me disa nga pyetjet:

- Çka nënkupton me shenjën - rrezik i kategorisë ndalim?
 - Çka nënkupton me shenjën - rrezik i kategorisë së detyrueshme?
 - Çka nënkupton me shenjën - rrezik i kategorisë paralajmërim?
- Bashkëbisedojmë që të fitojmë bindjen te fëmijët dhe të jenë më të vëmendshëm.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit të shenjave të rrezikut dhe kategorizimin e tyre.

Detyrë:

Vizatojnë shenjat e rrezikut për mbeturinat.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Argumenton shkallën e rrezikut për secilën mbeturinë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I-8, II-8, V-8, VI-2.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 6:1, 9:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndikimi i cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon ndikimin e cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut;
- Identifikon ndotësit më të mëdhenj të ajrit dhe të tokës;
- Tregon se si duhet të kujdesemi për mjedis cilësor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Bazë, fletore pune, projektor (eventuale), fotografi dhe ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Organizues grafik

Tymi nga uzinat,
termocentralet

Ndotësit e
mjedisit jetësor

Tymi nga makinat, djegia e lëndëve
të ndryshme

Mjedisi dhe shëndeti

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Cilësia e ajrit;
- Monoksidi i karbonit;
- Termocentralet;
- Riciklimi i mbeturinave;
- Mbeturinat toksike.

Fjalorthi:

Materie toksike - materie të rrezikshme helmuese.
Astma - zënia e frymës a vështirësimi i frymëmarrjes, për shkak të alergjisë etj.
Aktiviteti ekonomik - zhvillimi ekonomik.
Konsumi - shpenzimi.

Ndikimi i cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut

Mjedisi ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e njeriut dhe ka rol kryesor në cilësinë e jetës, si dhe në jetëgjatësinë. Cilësia e dobët e ajrit dhe ndotja e mjedisit është e lidhur me dëmtimin afatgjatë të sistemeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare. Pastaj, tymi që përmban materie toksike, mund të jetë shkaktar i sëmundjeve të zemrës, por edhe i shfaqjes së sëmundjeve të rrezikshme të rrugëve të frymëmarrjes.

Cilësia e dobët e ujit mund të çojë në sëmundje të sistemit të tretjes dhe probleme të tjera. Disa materie kimikate përreth shtëpisë dhe vendeve të punës mund të kontribuojnë në helmime akute dhe efekte të tjera toksike. Në botë, gati 11.6% e të gjitha vdekjeve shkaktohen nga ndotja e mjedisit.

Cilësia e dobët e mjedisit ka ndikimin e saj më të madh në gjendjen shëndetësore të njerëzve. Ajri, toka dhe uji i pastër janë elemente thelbësore për një mjedis të shëndetshëm të komunitetit. Një mjedis cilësor, pa tym, monoksid të karbonit dhe materie toksike, ndihmon në parandalimin e sëmundjeve dhe problemeve të tjera shëndetësore. Zbatimi i standardeve dhe i rregulloreve mjedisore, monitorimi i niveleve të ndotjes, ndërtimi i mjediseve sipas mënyrës së shëndetshme të jetesës mund të përmirësojnë shëndetin dhe cilësinë e jetës për të gjithë popullatën.



Ndotja e ujit dhe e ajrit nga fabrikat dhe mbeturinat

Mjedisi dhe shëndeti

Mjediset, siç janë: parqet, gjelbërimit, si dhe mënyra e transportit, do të ndikojnë si në shëndetin tonë, ashtu edhe në cilësinë e mjedisit. Për shembull, përdorimi i biçikletës si një mënyrë e transportit e rrit aktivitetin fizik dhe e zvogëlon ndotjen.

Te ne, ndotësit më të mëdhenj të ajrit janë automjetet, termocentralet, si dhe djegia e drurit dhe e qymyrit për ngrohje gjatë periudhës së dimrit. Ndërsa, ndotja e tokës dhe e ujit të lumenjve me materiale toksike shkaktohet nga fabrikat e ndryshme. Që të kemi një mjedis cilësor, duhet që të zbatohen rregulloret mjedisore, të cilat i ka secili shtet.



Ndotja e mjedisit nga materiet toksike



Pyetje:

- Si ndikon cilësia e mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut?
- Tregoni se si duhet të kujdesemi që të kemi mjedis cilësor.
- Cilët janë ndotësit më të mëdhenj të ajrit dhe të tokës?
- A është i madh numri i vdekjeve që shkaktohen nga ndotja e mjedisit?

53



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Marrëdhënie pyetje-përgjigje*

E lexojnë tekstin e parashtruar për ndotësit që ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe sëmundjet që shkaktohen nga ajri i ndotur. Nxënësit marrin shënime dhe më vonë diskutojnë në grupe ose çifte.



Ndotja e mjedisit nga materiet toksike



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit *Mendo - Krijo dyshe - Diskuto*

Diskutojnë çiftet për shënimet e nxjerra për ndotësit, po ashtu hapin debate edhe në grupe, për të gjetur mënyrën për parandalimin e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për njohjen e ndotësve, ndikimin që kanë në shëndetin e njeriut dhe si të mbrojmë mjedisin tonë jetësor.

Detyrë:

Hulumtojnë për ndotës të tjerë që ndikojnë në keqësimin e shëndetit të njeriut.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon ndikimin e cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-8, IV-7, V-9.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6:1, 9:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si ta mbrojmë mjedisin dhe shëndetin tonë?

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon ndikimin e cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut;
 - Zbaton disa veprime për ruajtjen e mjedisit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, fotografi të ndryshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Organizues grafik

Pasi mbeturinat e tepërta janë brengë e madhe për shëndetin tonë, diskutojmë për mënyrat e mundshme të eliminimit të përdorimit të disa gjërave.


Kam mësuar	Dua të mësoj
<ul style="list-style-type: none"> • Di që shishet e plastikës janë të dëmshme; • Qeset e plastikës duhen hequr nga përdorimi. 	Me çfarë zëvendësohen pelenat? Si të ndikojmë në vetëdijësim të popullatës për mospërdorim të tyre?

Mjedisi dhe shëndeti
 * Si ta mbrojmë mjedisin dhe shëndetin tonë?

Në ditët e sotme, ne po hedhim gjithnjë e më shumë mbeturina. Kjo rritje e sasisë së mbeturinave e sidomos në zonat urbane do të rritë edhe brengosjen e njeriut për këtë dukuri. Prandaj, nevojiten veprime që e zvogëlojnë ndotjen e mjedisit nga rritja e madhe e mbeturinave.



Mbllil pemë dhe fito një shok në jetën tënde. Kujdesu për të dhe për ambientin përreth.



Mjedisi dhe shëndeti

Si ta mbrojmë mjedisin dhe shëndetin tonë?

Në ditët e sotme, ne po hedhim gjithnjë e më shumë mbeturina. Kjo rritje e sasisë së mbeturinave e sidomos në zonat urbane do të rritë edhe brengosjen e njeriut për këtë dukuri. Prandaj, nevojiten veprime që e zvogëlojnë ndotjen e mjedisit nga rritja e madhe e mbeturinave.



Tullumbacet
6 MUAJ




Kutitë e kartonit
për qumësht
5 VJET



Qeset plastike
10-20 VJET



Polisteroli
50 VJET



Pelenat
450 VJET



Shisheet plastike
450 VJET

Mbill pemë dhe fito një shok në jetën tënde. Kujdesu për të dhe për ambientin përreth.



54



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

*Mësim i përqëndruar në argumente -
Veprimtari*

Dalim në oborrin e shkollës dhe mbledhim mbeturina dhe argumentojmë për secilin send për sa vjet do të pastrohet ajri për shëndetin tonë.

Çfarë mblodhëm?	Koha e zhdukjes



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Diskutimi - Pro dhe kundër

Besoj që njeriu s'i ka hedhur!
Nxënësit japin mendimet e tyre lidhur me po-
himin. Argumentojnë mendimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për shpjegimin e ndikimit të mbeturinave të ndryshme në shëndetin e njeriut dhe mjedisit dhe për pjesëmarrjen aktive në veprimtarinë e pastrimit dhe diskutimit.

Detyrë:

Të hulumtojnë se me çfarë tjetër mund të ndikojmë për ruajtjen e mjedisit dhe të shëndetit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Krijon porosi për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-4, II-3, III-1, V-1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6:1, 9:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Disa porosi për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon mënyrat për ruajtjen e cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, fotografi dhe ilustrime të ndryshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Paraqesim fotografinë dhe diskutojmë me nxënësit duke i nxitur edhe me pyetje të përshtatshme: Pse duhet të kursejmë ujin? Pse duhet të ngasim më shumë biçikletën? etj.



★ Disa porosi për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit



Kurseje ujin!



Ricikloji materialet e ndryshme!



Ec më këmbë ose përdore biçikletën tënde!



Reduktoji mbeturinat!



Mbill bimë!



Thuaju jo qeseve plastike!



Përdor shishe qelqi, që mund të pastrohen!



Kurseje energjinë elektrike!



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Tabela e koncepteve

Përdor shishe qelqi, që mund të pastrohen!	
Kurseje energjinë elektrike!	
Mbill bimë!	
Redukto, ripërdor ose riciklo mbeturinat! RRR	



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Diskutim me gjithë klasën

Pasi nxënësit kanë plotësuar tabelën e përgatitur paraprakisht nga mësuesja/mësuesi, disa nxënës lexojnë punimet e tyre.

Më pas fillojmë diskutimin me nxënësit. Kërkojmë që të identifikojnë edhe mënyra të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për identifikimin e veprimeve pozitive për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Detyrë:

Shkruajnë një listë me rregulla për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj mjedisit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathhtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënimit të temës:

Argumenton brengosjen e njeriut për sasinë e mbeturinave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-4,II-3,III-1, V-1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6:1, 9:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shqetësimi i njeriut për sasinë e mbeturinave

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Tregon disa lloje të mbeturinave;
- Identifikon se si mund të bëhet zvogëlimi i sasisë së mbeturinave;
- Shpjegon si bëhet ndarja e mbeturinave për riciklim.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, fotografi të ndryshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Shpjegim i përparuar

Njerëzit janë të shqetësuar për rritjen e sasisë së mbeturinave, sidomos në zonat urbane. Për ta zvogëluar ndotjen e mjedisit, nevojiten për t'u ndërmarrë veprime të caktuara.

Parashtrijmë pyetje nxënësve:

- *Nga çka varet sasia e mbeturinave?*
- *Si mund të zvogëlojmë sasinë e mbeturinave?*
- *Si bëhet ndarja e mbeturinave për riciklim?*

Mjedisi dhe shëndeti

Shqetësimi i njeriut për sasinë e mbeturinave

Njerëzit janë të brengosur për rritjen e sasisë së mbeturinave, sidomos në zonat urbane. Për ta zvogëluar ndotjen e mjedisit, nevojiten për t'u ndërmarrë veprime të caktuara.

Kemi lloje të ndryshme të mbeturinave, duke përfshirë mbeturinat e ngurta komunale, mbeturinat bujqësore dhe shtazore, mbeturinat mjekësore, mbeturinat radioaktive, mbeturinat industriale të rrezikshme ose jo të rrezikshme etj. Sasia e mbeturinave varet nga aktiviteti ekonomik, konsumi dhe rritja e popullatës.

Mbeturinat vendosen në deponi të mbeturinave. Sipërfaqet e caktuara për deponi po mbushen shumë shpejt, andaj kërkohet të gjenden sipërfaqe të tjera.



Deponi pa riciklim të mbeturinave



Deponia ku ndahen mbeturinat për riciklim

Me qëllim të zvogëlim të sasisë së mbeturinave, në shtete të ndryshme bëhet riciklimi i mbeturinave, si dhe përdorimi i mbeturinave për prodhim të energjisë elektrike dhe të nxehtësisë.

Riciklimi është procesi i mbledhjes së mbetjeve dhe i ripërpunimit të tyre në materiale të dobishme. Me riciklim nënkuptohet që mbeturinat, si shisheet e plastikës, qeset e plastikës ndahen, grumbullohen dhe dërgohen në fabrikat përkatëse, ku përdoren për prodhimin e shisheve të plastikës, si dhe qeseve të plastikës. Mbeturinat duhet t'i ndajmë (klasifikojmë) që në shtëpi (metale, letra, plastikë, qelq, organike etj.). Pastaj mund të bëhet riciklimi i tyre.

Për mbrojtjen e mjedisit, në shumë shtete janë marrë masa për ta zvogëluar përdorimin e qeseve të plastikës.



Pyetje:

- Tregoni disa lloje të ndryshme të mbeturinave.
- Nga çfarë varet sasia e mbeturinave?
- Për çka përdoren mbeturinat me qëllim të zvogëlim të sasisë së tyre në disa shtete?
- Si bëhet ndarja e mbeturinave për riciklim?

Mjedisi dhe shëndeti

*** Shqetësimi i njeriut për sasinë e mbeturinave**

Njerëzit janë të brengosur për rritjen e sasisë së mbeturinave, sidomos në zonat urbane. Për ta zvogëluar ndotjen e mjedisit, nevojiten për t'u ndërmarrë veprime të caktuara.

Kemi lloje të ndryshme të mbeturinave, duke përfshirë mbeturinat e ngurta komunale, mbeturinat bujqësore dhe shtazore, mbeturinat mjekësore, mbeturinat radioaktive, mbeturinat industriale të rrezikshme ose jo të rrezikshme etj. Sasia e mbeturinave varet nga aktiviteti ekonomik, konsumi dhe rritja e popullatës.

Mbeturinat vendosen në deponi të mbeturinave. Sipërfaqet e caktuara për deponi po mbushen shumë shpejt, andaj kërkohet të gjenden sipërfaqe të tjera.



Deponi pa riciklim të mbeturinave

Deponia ku ndahen mbeturinat për riciklim

Me qëllim të zvogëlimit të sasisë së mbeturinave, në shtete të ndryshme bëhet riciklimi i mbeturinave, si dhe përdorimi i mbeturinave për prodhim të energjisë elektrike dhe të nxehtësisë.

Riciklimi është procesi i mbledhjes së mbetjeve dhe i ripërpunimit të tyre në materiale të dobishme. Me riciklim nënkuptohet që mbeturinat, si shisheet e plastikës, qeset e plastikës ndahen, grumbullohen dhe dërgohen në fabrikat përkatëse, ku përdoren për prodhimin e shisheve të plastikës, si dhe qeseve të plastikës. Mbeturinat duhet t'i ndajmë (klasifikojmë) që në shtëpi (metale, letra, plastikë, qelq, organike etj.). Pastaj mund të bëhet riciklimi i tyre.

Për mbrojtjen e mjedisit, në shumë shtete janë marrë masa për ta zvogëluar përdorimin e qeseve të plastikës.



Pyetje:

- Tregoni disa lloje të ndryshme të mbeturinave.
- Nga çfarë varet sasia e mbeturinave?
- Për çka përdoren mbeturinat me qëllim të zvogëlimit të sasisë së tyre në disa shtete?
- Si bëhet ndarja e mbeturinave për riciklim?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Tabela e koncepteve

Metal	Letër	Plastikë	Ushqime	Tekstil



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Shqyrtim kategorizues

Me riciklim nënkuptohet që mbeturinat, si shisheet e plastikës, qeset e plastikës etj., ndahen, grumbullohen dhe dërgohen në fabrikat përkatëse dhe përftohen produkte të reja.



Deponi pa riciklim të mbeturinave

Deponia ku ndahen mbeturinat për riciklim

Nxënësit përshkruajnë deponinë pa riciklim dhe me riciklim.

Cila është më e dobishme? Si të zvogëlojmë sasinë e mbeturinave?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për njohjen e mbeturinave të riciklueshme, mënyrën se si bëhet ndarja e mbeturinave për riciklim dhe zvogëlimin e tyre.

Detyrë:

Të praktikojnë ndarjen e mbeturinave në shtëpitë e tyre, duke e dëshmuar këtë me foto të punës praktike.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV
Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përpunon gjëra të ndryshme me materiale ricikluese.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II-5, II-8, III-4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përpunimi i gjërave të ndryshme me materiale ricikluese - Punimi i shportës me qese plastike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
• Punon shportën me qese të plastikës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.



Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, qese plastike me ngjyra të ndryshme, gërshtë, gjilpërë, penj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Shpjegim i përparuar - Aktiviteti


Fillimisht kontrollohen mjetet dhe materialet e punës. Rikujtojmë rregullat për përgatitjen e hapësirave punuese dhe kujdesin gjatë përdorimit të mjeteve të punës. Shpjegojmë ecurinë e përpunimit të qeseve të plastikës; shtrirja e qeseve, prerja në shirita, pastaj lidhja, e në fund thurja. Shpjegojmë dhe demonstrojmë kërrabëzen e thurjes më të trashë, pastaj fillojmë duke e formuar një nyjë dhe pastaj thurim, duke pasur kujdes që mos të ngatërrohen fijet e qeseve.



★ Përpunimi i gjërave të ndryshme me materiale ricikluese

✱ Punimi i shportës me qese plastike

● Në fillim, qeset e plastikës i presim në shiritat dhe i formojmë gërshetat, siç është treguar në figurat në vazhdim.



● Me gërshetat e formuara me shiritat e qeseve plastike, vazhdojmë ta formojmë pjesën e poshtme të shportës. I ngjitur gërshetat me gjilpërë dhe penj.



● Vazhdojmë me ndërtimin e pjesës së epërme të shportës, gjithnjë duke i ngjitur gërshetat me gjilpërë dhe penj, derisa ta përfundojmë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Tabela e koncepteve

Shtrirja e qeseve				
Prerja e qeseve ne fije				
Lidhja e fijeve				
Gërshetat				



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Ekspozita e klasës

Në një kënd të klasës ekspozohen punimet e nxënëve. Ata lihen të lirë të vëzhgojnë punën e grupeve të tjera. Diskutojnë për vështirësitë dhe sfidat gjatë realizimit të shportës.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për veprimtarinë praktike, bashkëpunimin në grup dhe diskutimet për procesin e realizimit të shportës.

Detyrë:

Hulumtojnë në internet se si mund të shfrytëzohen qeset e përdorura plastike. Sipas dëshirës, realizojnë një punim.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përpunon gjëra të ndryshme me materiale ricikluese.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II-5, II-8, III-4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çantë e thurur me grep

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Punon çantën me qese të plastikës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, qese plastike, grep për thurje etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:


Përgatitja për të nxënë

Shpjegim i përparuar - Demonstrim

E shpjegojmë ecurinë e përpunimit të qeseve të plastikës, shtrirja e qeseve, prerja në shirita, pastaj lidhja dhe në fund thurja. Shpjegojmë dhe demonstrojmë kërrabëzen e thurjes me të trashë, pastaj fillojmë duke e formuar një nyjë dhe pastaj thurim duke pasur kujdes që mos të ngatërrohen fijet e qeseve. Pastaj krijojmë fillin për thurje: Pasi t'i kemi krijuar rrathët e plastikës, ata duhet të gërshetohen si në figurë, që të krijohet filli për thurje. Pas gërshetimit, tërhiqen skajet e rrathëve dhe rrathët do të lidhen ndërmjet.



Mjedisi dhe shëndeti



1 Përfundojmë 14 rreshta e gjysmë me vegëza të dyfishta. Nëse thurjet janë më të shtrënguara ose më të lira, mund të na duhet të bëjmë më shumë ose më pak rreshta. Qëllimi është që çanta të jetë pak më e gjërë sesa është e gjatë. Tani do të vazhdojmë t'i bëjmë 6 thurje me një vegëz.

2 Tani jemi gati ta bëjmë dorezën e parë. E thurim një zinxhir me 20 vegëza. E mbajmë çantën lart për ta parë nëse na pëlqen ajo gjatësi; nëse duam doreza më të gjata/më të shkurtra. Duhet të jemi të kujdesshëm që të mos e përdredhim dorezën derisa jemi duke e lidhur zinxhirin me çantën. I numërojmë 8 vegëza nga vendi ku kemi filluar zinxhirin dhe e bashkojmë atë me çantën përmes një thurjeje vegëze me grep.

I thurim edhe 12 vegëza të vetme me grep në anën tjetër.

Kështu do ta bëjmë dorezën tjetër, duke e thurur zinxhirin me 20 vegëza. I llogarisim 8 vegëza dhe e lidhim zinxhirin me një vegëz, ashtu si e kemi bërë në anën tjetër për dorezën e parë. Sigurohemi që ato të duken të barabarta. Nëse jo, e gjejmë vendin ku janë dhe e lidhim zinxhirin në çantë.

Tani vazhdojmë me thurje të një rendi me vetëm një vegëz dhe mbi dorezë.

Vazhdojmë të thurim në pjesën e zinxhirit, duke e zgjeruar dorezën. Po ashtu, vijojmë me thurje me një vegëz dhe thurim përgjatë dorezës tjetër.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Punë praktike - Aktivitet

Pasi të jenë dhënë sqarimet e nevojshme dhe është demonstruar procesi nga mësimsdhënësi, nxënësit në grupe ndajnë përgjegjësitë dhe fillojnë realizimin e çantës.

Nxënësit në vazhdimësi vëzhgohen dhe ndihmohen nëse kanë nevojë. Nxënësit që janë më të shkathët ndihmojnë pjesëtarët e grupit.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Ekspozita e klasës

Në një kënd të klasës ekspozohen punimet e nxënëve. Ata lihen të lirë të vëzhgojnë punën e grupeve të tjera. Diskutojnë për vështirësitë dhe sfidat gjatë realizimit të shportës.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për veprimtarinë praktike, bashkëpunimin në grup dhe diskutimet për procesin e realizimit të çantës.

Detyrë:

Të vazhdojnë punën e thurjes në shtëpi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Ndërgjegjësohet dhe informohet për sigurinë në internet.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I-1, II-3, III-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 2:1, 4:1, 4:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Siguria në internet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përmendin disa rregulla që ju ndihmojnë të jeni të sigurt në internet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, laptop ose kompjuter, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Flasim për shfrytëzimin e rrjeteve sociale nga nxënësit; çfarë shikojnë, si komunikojnë etj.



Mediet

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Interneti;
- Komunikimi online;
- Tekstet dhe mesazhet.

Fjalorthi:

Online - e qasshme në internet.
SMS (nga anglishtja) - shërbim i mesazhit të shkurtër.
Postim - dërgim.

Mediet

*** Siguria në internet**

Interneti është një burim i dobishëm i informacioneve kur përdoret në mënyrë të sigurt, duke na ndihmuar të mësojmë dhe madje të mbajmë lidhje e komunikim me miqtë, anëtarët e familjes e të tjerë.

Siguria në internet është thelbësore në botën e sotme të komunikimit online të telefonave, të tabletëve dhe madje edhe të videolejërave.

Për fat të mirë, disa rregulla të thjeshta mund të na ndihmojnë të jemi të sigurt në internet:

- Pyetni një të rritur para se të hyjni në internet.
- Nëse diçka e çuditshme shfaqet në ekran, tregojini një të rrituri.
- Tregojini një të rrituri nëse një i huaj ju flet në internet.
- Gjithmonë pyesni nëse nuk jeni të sigurt për ndonjë gjë.

*** Përdorimi i kompjuterit për sigurinë në internet**

Për të komunikuar **online**, fëmijët në ditët e sotme përdorin:

- Pajisjet mobile, përfshirë telefonat celularë;
- Laptopët dhe kompjuterat personale;
- Konsolet e videolejërave.



60

Mediet

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Interneti;
- Komunikimi online;
- Tekstet dhe mesazhet.

Fjalorthi:

Online - e qasshme në internet.
 SMS (nga anglishtja) - shërbim i mesazhit të shkurtër.
 Postim - dërgim.

Mediet

*** Siguria në internet**

Interneti është një burim i dobishëm i informacioneve kur përdoret në mënyrë të sigurt, duke na ndihmuar të mësojmë dhe macje të mbajmë lidhje e komunikim me miqtë, anëtarët e familjes e të tjerë.
 Siguria në internet është thelbësore në botën e sotme të komunikimit online të telefonave, të tableteve dhe macje edhe të videolojërave.
 Për fat të mirë, disa rregulla të thjeshta mund të na ndihmojnë të jemi të sigurt në internet:

- Pyetni një të rritur para se të hyni në internet.
- Nëse diçka e çuditshme shfaqet në ekran, tregojini një të rrituri.
- Tregojini një të rrituri nëse një i huaj ju flet në internet.
- Gjithmonë pyesni nëse nuk jeni të sigurt për ndonjë gjë.

*** Përdorimi i kompjuterit për sigurinë në internet**

Për të komunikuar **online**, fëmijët në ditët e sotme përdorin:

- Pajisjet mobile, përfshirë telefonat celularë;
- Laptopët dhe kompjuterat personalë;
- Konsolat e videolojërave.



60



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
 Përpunimi i përmbajtjes**
Parashikimi me terma paraprakë

Interneti
Rreziku
Siguria

Disa rregulla të thjeshta mund të na ndihmojnë të jemi të sigurt në internet, diskutojmë me nxënësit për secilen nga këto rregulla.

Pyetni një të rritur para se të hyni në internet.
Nëse diçka e çuditshme shfaqet në ekran, tregojini një të rrituri.
Tregojini një të rrituri nëse një i huaj ju flet në internet.
Gjithmonë pyesni nëse nuk jeni të sigurt për ndonjë gjë.



**Përforcimi:
 Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**
Sistemi ndërveprues i shënimeve

Pasi nxënësit lexojnë dhe dëgjojnë, e dallojnë citatin dhe e shënojnë komentin, u parashtrajmë pyetjen:

Çfarë ju bëri të mendoni për rrezikun e komunikimit me njerëz të panjohur?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e rregullave për sigurinë në internet dhe pjesëmarrjen në diskutim.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 36.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathhtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Prezanton me anë të kompjuterit sigurinë e fëmijëve në internet.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1, II-3, III-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2:1, 4:1, 4:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i kompjuterit për sigurinë në internet

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Liston pajisjet për komunikim online;
- Tregon për rëndësinë e ruajtjes së të dhënave personale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë etj.).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, laptop ose kompjuter.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësve
Bashkëbisedim

Pyesim nxënësit për mënyrat e komunikimit.

Po për komunikimin online, cilat mjete dhe pajisje mund të përdorin fëmijët?

Pajisjet mobile, përfshirë telefonat celularë, laptopët dhe kompjuterat personalë etj.

Mbajmë shënime për përgjigjet e nxënësve.

Mediet

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Interneti;
- Komunikimi online;
- Tekstet dhe mesazhet.

Fjalorthi:

Online - e qasshme në internet.
SMS (nga anglishtja) - shërbim i mesazhit të shkurtër.
Postim - dërgim.

Mediet

*** Siguria në internet**

Interneti është një burim i dobishëm i informacioneve kur përdoret në mënyrë të sigurt, duke na ndihmuar të mësojmë dhe madje të mbajmë lidhje e komunikim me miqtë, anëtarët e familjes e të tjerë.

Siguria në internet është thelbësore në botën e sotme të komunikimit online të telefonave, të tabletëve dhe madje edhe të videolejërave.

Për fat të mirë, disa rregulla të thjeshta mund të na ndihmojnë të jemi të sigurt në internet:

- Pyetni një të rritur para se të hyjni në internet.
- Nëse diçka e çuditshme shfaqet në ekran, tregojini një të rrituri.
- Tregojini një të rrituri nëse një i huaj ju flet në internet.
- Gjithmonë pyesni nëse nuk jeni të sigurt për ndonjë gjë.

*** Përdorimi i kompjuterit për sigurinë në internet**

Për të komunikuar **online**, fëmijët në ditët e sotme përdorin:


- Pajisjet mobile, përfshirë telefonat celularë;
- Laptopët dhe kompjuterat personalë;
- Konsolat e videolejërave.



60

Ata, duke u kycur online:

- Vizitojnë botët virtuale;
- Luajnë lojëra me shumë përdorues;
- U dërgojnë tekste ose mesazhe të çastit njëri tjetrit;
- Ngarkojnë profilin dhe ndërveprojnë me të tjerët në faqet e rrjeteve sociale;
- Shikojnë dhe postojnë video;
- Shkarkojnë muzikë, filma dhe më shumë;
- Krijojnë art dhe i ngarkojnë këto krijime artistike që t'i shohin të tjerët;
- Bëjnë kërkime.



Me tekste ose mesazhe të çastit atyre u mundësohet që të komunikojnë në çdo kohë në kompjuter ose telefon celular.

Faqet e popullarizuara të videove janë: **YouTube dhe Vimeo**. Këtu shfrytëzuesit shikojnë dhe dërgojnë video.



Konsolet, si: **Xbox Live, PlayStation**, janë gjithnjë e më të lidhura në internet, duke ua mundësuar fëmijëve të luajnë me shokë dhe miq. Këtu, lojtarët lejohen të flasin në kohë reale, duke përdorur kufje dhe mikrofova.

Mirëpo, fëmijët mund të ekspozohen ndaj bisedave të çuditshme ose më keq. Fëmijët, gjatë përdorimit online të internetit, mund të hasin në materiale që përmbajnë viruse të ndryshme, përmbajtje shqetësuese etj. Andaj, gjatë punës online, duhet t'u përmbahemi rregullave të caktuara, për t'u mbrojtur nga informacione dhe veprime të dëmshme.

61



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues

Analizojmë, shkruajmë të dhënat nga teksti dhe komentojmë për dëmet që mund të lajmërohen nga pakujdesia kur:

- luajnë lojëra me shumë përdorues;
- u dërgojnë tekste ose mesazhe të çastit njëri-tjetrit;
- ngarkojnë profilin dhe ndërveprojnë me të tjerët në faqet e rrjeteve sociale;
- shikojnë dhe postojnë video;
- shkarkojnë muzikë dhe filma.

Sqarojmë se fëmijët mund të ekspozohen ndaj bisedave të çuditshme ose më keq, prandaj ata gjatë përdorimit online të internetit, mund të hasin në materiale që përmbajnë viruse të ndryshme, përmbajtje shqetësuese etj.


Andaj, gjatë punës online, duhet t'u përmbahemi rregullave të caktuara, për t'u mbrojtur nga informacione dhe veprime të dëmshme.

Nxënësit njoftohen me rregullat e përdorimit të sigurt të internetit.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Ruaje fjalën e fundit për mua

Nxënësit udhëzohen që individualisht të shkruajnë në fletore se si e kanë praktikuar deri tani internetin; si i kanë bërë kërkimet dhe a bien ato ndesh me informacionet e marra. Diskutojmë së bashku.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e mënyrave të komunikimit në internet dhe njohjen e rregullave për lundrim të sigurt gjatë kërkimit.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 37.

Reflektim për rrezidhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathhtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Ndërgjegjësohet dhe informohet për sigurinë në internet.
 Kupton rëndësinë e ruajtjes së të dhënave personale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1, II-3, III-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2:1, 4:1, 4:2, 4:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rëndësia e ruajtjes së të dhënave personale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon rëndësinë e ruajtjes së të dhënave personale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë etj.).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, laptop ose kompjuter.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Për të rikujtuar njohuritë paraprake, hapim diskutimin duke parashtruar pyetje:

- *A mund t'i japim të dhënat personale çdo personi me të cilin komunikojmë? Pse?*
- *A është e sigurt të hyjmë në çdo faqe?*
- *Pse duhet internetin ta përdorim në prani të personave të rritur?*
- *A guxojmë të shpërndajmë fjalëkalimin? Pse?*



Mediet



Pyetje:

- Përmendni disa rregulla që ju ndihmojnë të jeni të sigurt në internet.
- Çfarë bëni zakonisht kur jeni të kyçur online në kompjuter ose telefon celular?
- Sa ju ndihmon interneti në gjetjen e informacioneve për të zgjidhur detyra të caktuara?

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Të dhënat personale;
- Fjalëkalimi;
- Shkarkimi dhe ngarkimi nga interneti.

Fjalorthi:

- Formular - fletë me disa kërkesa që kërko het për t'u plotësuar.

Rëndësia e ruajtjes së të dhënave personale



Përdoreni kompjuterin vetëm në praninë e të rriturve.



Asnjëherë mos tregoni të dhënat personale (emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën e shtëpisë etj.)



Kontrolloni me prindërit/kujdestarët ose mësuesin/en çfarëdo që shkarkoni nga interneti.



Mos plotësoni formularë online pa pyetur prindërit/kujdestarët ose mësuesin/en.



Asnjëherë mos ia tregoni dikujt fjalëkalimin.



Asnjëherë mos takoni ndonjë person që e keni njohur nëpërmjet internetit.



Tregojuni prindërve/kujdestarëve ose mësuesit/es nëse vëreni diçka që ju shqetëson.



Mos u dërgoni fotografi personave të panjohur në internet.

62



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues -
Puna me tekst**

Dikutojmë për situatat e paraqitura në tekstin e nxënësit:

- Përdoreni kompjuterin vetëm në praninë e të rriturve.
- Mos plotësoni formularë online pa pyetur prindërit/kujdestarët ose mësuesin/en.
- Asnjëherë mos tregoni të dhënat personale (emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën e shtëpisë etj.)
- Kontrolloni me prindërit/kujdestarët ose mësuesin/en çfarëdo që shkarkoni nga interneti.
- Asnjëherë mos takoni ndonjë person që e keni njohur nëpërmjet internetit.
- Asnjëherë mos ia tregoni dikujt fjalëkalimin.
- Tregojuni prindërve/kujdestarëve ose mësuesit/es nëse vëreni diçka që ju shqetëson.
- Mos u dërgoni fotografi personave të panjohur në internet.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët
Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Nxënësit e pavarur u përgjigjen pyetjeve:

- Sa shpesh e përdorni internetin brenda ditës?
 - Përshkruani ndonjë ngjarje të pazakontë që ju ka ndodhur gjatë shfrytëzimit të internetit. Si keni reaguar?
- Disa nxënës lexojnë përgjigjet përpara shokëve/shoqeve të klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e dallimit të veprimeve të duhura, për rëndësinë e ruajtjes së të dhënave personale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë etj.).

Detyrë:

Fletore pune, faqe 38.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Kupton që interneti përmban një sasi shumë të madhe informacioni për kërkimin dhe gjetjen e informacionit të kërkuar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-8, II-4, III-4, V-1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2:1, 4:1, 4:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kërkimi i informacioneve në internet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Aftësohen për kërkimin e informacionit në internet;
- Përshkruajnë mënyrën e kërkimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, laptop ose kompjuter.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Praktikimi i të dëgjuarit dhe bashkëbisedimit aktiv

Parashtrajmë pyetje:

- Si i kërkoni ju informacionet në internet?
- A kërkoni ndihmë nga të rriturit?
- Cilat informacione gjeni në internet?





Pyetje:

- Sa shpesh e përdorni internetin brenda ditës?
- Përkrahuni ndonjë ngjarje të pazakontë që ju ka ndodhur gjatë shfrytëzimit të internetit. Si keni reaguar?

* Kërkimi i informacioneve në internet

Për të kërkuar një informacion në internet, zbatojmë këtë ecuri:

- Hapim faqen e internetit në kompjuter, duke shtypur komandën: **google.com**
- Shtypim tekstin për lëndën për të cilën/ rreth së cilës duam të kërkojmë informacione;

Google Search

Google Search

- Në ekran na paraqiten vegëza të shumta, ne zgjedhim këtë njësi mësimore:

www.youtube.com > watch

e Mesimi Klasa 4 - 4604 Matematikë - Shumëzimi i numrave ...



e Mesimi Klasa 4 - 4604 Matematikë - Shumëzimi i numrave treshifrorë me një numër dyshifrorë. 5,856 ...
Apr 22, 2020 - Uploaded by Kaliko.com

- Klikojmë mbi fotografinë e paraqitur dhe e përcjellim orën e mësimi.



Në televizor transmetohen programe të shumta edukative për fëmijë. Ato përcjellin mesazhe edukative, ku na përgatisin për jetën, si:



- 1,2,3 fillo - emision edukativ garues; Të luajmë shkollash, Mëso alfabetin nëpërmjet fjalëve; Për Pan, Power kids, Udhëtim me kaishët, Njëmbëdhjetëshja e Inazumës, Çamarrokët e kopshtit.

63



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Copëzat e përziëra

Përgatisim copëza me aplikacione të ndryshme për shkarkim në internet, i ndajmë nxënësit në grupe dhe, varësisht nga copëzat që përzgjedhin ata, flasim për çfarë u nevojiten dhe e shfrytëzojnë atë shkarkim.

Vazhdojmë me sqarimet: Për të kërkuar një informacion në internet, zbatojmë këtë ecuri:

- Hapim faqen e internetit në kompjuter, duke shtypur komandën: **google.com**.
- Shtypim tekstin për lëndën që kërkojmë informacione.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Duke ndjekur udhëzimet nga teksti dhe informacionet e marra, nxënësit individualisht kërkojnë përmbajtje edukative në internet.

Disa nxënës përshkruajnë me gojë mënyrën e kërkimit.

Google

E mesimi shkathtësi për jetë

Kërko në Google

Ndihem me fat

Google ofrohet në: English

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shkathtësinë e kërkimit në internet dhe përshkrimin e mënyrës së kërkimit.

Detyrë:

Kërko emisione edukative në internet, shkruaj për gjetjet.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Argumenton rolin e radios, TV-së, medias sociale etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-8, II-4, III-4, V-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2:1, 4:1, 4:2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Radioja, televizioni dhe mediet sociale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon rolin dhe rëndësinë e informacioneve në radio, televizion dhe tregon dallimin e tyre.
- Tregon çfarë janë mediet sociale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, fletore pune, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Bashkëbisedim për njohuritë paraprake

- Cilat programe i dëgjoni në radio?
- Përshkruani emisionin, filmin ose programin tuaj të pëlqyer në televizor.

Mediet

Fjalë dhe shprehje kyçe:

- Mediet;
- Informim;
- Komunikim.

Fjalorthi:

- Vrullshëm - me lëvizje të shpejtë.
- Ndërveprim - bashkëpunim.
- Emetoj - vë në qarkullim; transmetoj.

Radioja, televizioni dhe mediet sociale

Radioja është pajisje përmes së cilës marrim informata nga më të ndryshmet. Radioja është zbuluar shumë kohë më parë dhe informimi bëhet me anë të të dëgjuarit.

Aty ka programe të llojllojshme, duke filluar nga ato argëtuese, edukative, sportive etj.



Televizioni bën pjesë në pajisjet e rëndësishme për komunikim; është i pëlqyer nga të gjitha moshat, duke filluar nga fëmijët deri te të moshuarit. Njëpërmjet radios dhe televizionit, ne mund të marrim informacione dhe të shohim panje të ndryshme në formë të tërthortë, ndërsa njëpërmjet internetit dhe rrjetëve sociale ne mund të komunikojmë drejtpërdrejt. Emisionet që emtohen janë nga më të ndryshmet, si edukativo-arsimore, sportive, zbulim-shkencore, kulturore, filma dhe informacione nga e tërë bota. Me anë të televizionit informohemi për ngjarjet që kanë ndodhur brenda ditës apo edhe në çast, pra përmes informimit përgatitëmi për gjërat që sjell e nesërma dhe, kështu, mësojmë e argëtohem.



Po ashtu, njëpërmjet radios dhe televizionit, transmetohen emisione për fëmijë, udhëhequr nga vetë ata, që janë mjaft edukative, argëtuese dhe informuese.

Mediet


Mediet sociale - në epokën e re në të cilën jemi duke jetuar ballafaqohemi me përdorimin e shpesh të faqeve të medieve sociale, të cilat konsiderohen një ndër aktivitetet më të zakonshme nga fëmijët dhe adoleshentët.

Çdo faqe online që lejon ndërveprim social, konsiderohet si medie sociale. Ajo i ndihmon fëmijët të mbajnë kontakte me të afërmit dhe miqtë.

Mediet sociale i kanë anëtarë pozitivë për komunikim dhe shkëmbim ndërveprues të ideve tona dhe janë pa pagesë, por vëmendje të veçantë duhet pasur se me kë shoqërohemi. Si anëtarë negativë mund të përmendim kohën e madhe të shpenzuar në mediet sociale. Kjo bën që ne pastaj të mos kemi kohë për aktivitete të tjera, si: aktivitete fizike, leximi i librave të ndryshëm, komunikimi me anëtarët e familjes etj. Prandaj është e rëndësishme t'i përdorim me orar të caktuar dhe nën mbikëqyrjen e prindërve a kujdestarëve.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të medieve sociale, si: **edukative, argëtuese, komunikuese** etj.

Shkruani nga një fjali që tregon se çfarë janë radioja, televizori dhe mediet sociale.



Pyetje:

- Cilat programe i dëgjoni në radio?
- Përshkruani emisionin, filmin ose programin tuaj të pëlqyer në televizor.
- Çfarë janë mediet sociale?



Mos harro!

Asnjëherë mos i trego të dhënat personale në kompjuter (emri, mbiemri, adresa e personit etj.).
Mos i dërgo fotografi të tua personit që nuk e njeh.
Asnjëherë mos tako ndonjë person që e ke njohur nëpërmjet internetit.

65



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues - Puna me tekst

Ndahen nxënësit në grupe dhe lexojnë pjesën e caktuar.

Grupi 1, 2 - Radio
Televizori

Grupi 3, 4 -




Grupi 5, 6 - Mediet sociale - edukative, argëtuese, komunikuese

Përfaqësuesi i secilit grup prezanton informacionet që kanë mësuar. Anëtarët e grupeve të tjera parashtrojnë pyetje.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diagram organizues

Shkruani nga një fjali që tregon se çfarë janë radioja, televizori dhe mediet sociale.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin e rolit dhe rëndësinë e radios, televizorit dhe mediave sociale.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 39, 40.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

